



Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë

Më 20 – 22 nëntor 2006, në Tiranë, u mbajt Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë me temën: *Bibliotekat shqiptare në botën e re demokratike*, një institucion tashmë i përbashkët i bibliotekarisë i Shqipërisë dhe i Kosovës. Konferenca u themelua në shtator të këtij viti, në kuadër të Muajit të Kulturës Shqipëri - Kosovë, dhe kjo marrëveshje u nënshkrua mes Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë – dr. Aurel Plasarit, dhe Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare – dr. Sali Bashota. Me këtë marrëveshje është vendosur

që Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë të organizohet për çdo vit: një vit në Tiranë, një vit në Prishtinë, nën përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë, dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës.

Kjo Konferencë do të trajtojë për çdo vit problemet më të ndjeshme që do të ndodhin, në proces, në fushën e praktikave bibliotekare të të dy vendeve, do të përcjellë zhvillimet e reja në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të modernizimit të bibliotekave, si dhe mundësinë për të hartuar

dhe realizuar projekte të përbashkëta nacionale.

Edicioni i parë i Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë u organizua në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe zgjati dy ditë.

Në veprimtarinë e Konferencës morë pjesë udhëheqës e përfaqësues të profilizuar në fusha specifike të bibliotekarisë nga Biblioteka Kombëtare e Tiranës, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, si dhe përfaqësues të qeverive e drejtues të bibliotekave rajonale të të dy vendeve.

/vijon në faqen 3/

KRIJOHET KONFERENCA KOMBËTARE E BIBLIOTEKONOMISË

Në vijim dhe plotësim të Marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (BKSh) dhe Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës (BKUK) merren vesh për themelimin e **Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë**.

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë është organizim i përbashkët i dy institucioneve dhe do të mbledhet nën kujdesin dhe mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës & Teknologjisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës.

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë do të ketë organizim të përvitshëm, përkatësisht: një vit në Tiranë, një vit në Prishtinë.

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë do të synojë:

- të analizojë dhe përgjithësojë zhvillimet aktuale në shkencën e bibliotekonomisë në të dyja vendet në ballafaqim me zhvillimet në shkallë evropiane dhe botërore;
- të pasqyrojë praktikatat dhe përvojat në zhvillimet e proceseve dhe shërbimeve bibliotekare në të dyja vendet;
- të nxisë bashkëpunimin për probleme të formimit dhe të kualifikimit profesional përmes organizimit të veprimtarive të përbashkëta;
- të nxisë implementimin e teknologjive të reja të informacionit në proceset dhe shërbimet bibliotekare;
- të ndihmojë për përditësimin me teorinë dhe praktikën bashkëkohore në fushën e bibliotekave duke nxitur bashkëpunimin me projekte me organizma të tilla si: KE, UNESCO, IFLA, CENL, LIBER etj. si dhe me biblioteka të veçanta të përparuara;
- të kontribuojë në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare posaçërisht në fushën e librit;
- të mbështesë mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- të mbrojë dhe të nxisë lirinë intelektuale;
- të promovojë veprimtaritë e përbashkëta bibliografike mes dy institucioneve me synim krijimin e katalogut përmbledhës duke kërkuar bashkëpunimin edhe të bibliotekave me koleksione albanologjike në Ballkan, Evropë dhe botë;
- të ideojë ekspozita, botime, veprimtari përkujtimore dhe manifestime të tjera të përbashkëta.

Çdo edicion i saj do të përkujdeset nga institucioni i vendit ku Konferenca mbledhet: Shqipëri (BKSh) ose Kosovë (BKUK).

Tema, data e mbledhjes së Konferencës dhe programi i veprimtarisë së saj propozohen nga një komitet i përbashkët bashkërendimi, i caktuar nga Drejtoritë e të dyja Institucioneve, dhe miratohen prej këtyre Drejtorive.

Tiranë, më 20 shtator 2006

Dr. Aurel PLASARI
Drejtor
Shqipëri (BKSh)

Dr. Sali BASHOTA
Drejtor
Kosovë (BKUK)

Në këtë numër



Bibliotekat shqiptare në botën e re demokratike.....	4
Poezia shqipe në Kosovë 1953-1980.....	6
Terminologjia e formatit MARC dhe definicionet e tyre	8
Sigurimi i fondeve muzikore në bibliotekë.....	12
Ndryshimet në strukturën e ISBN-së	15
Kujtesa vegjetale dhe minerale: e ardhmja e librit.....	18

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
DHE UNIVERSITARE
E KOSOVË



THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVO

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Dr. Sali Bashota

Kryeredaktor: Fazli Gajraku

Këshilli redaktues: Dr. Bahtie Gërbeshi-Zylfiu, Gjon Berisha, Besim Kokollari

Lektore: Hazbije Qeriqi • **Realizimi kompjuterik:** Hekuran Rexhepi

Fotoreporter: Bashkim Binaku

Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë

Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë

/vijon nga faqja 1/

Në seancën ceremoniale të hapjes përshëndetën Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë, z. Bujar Leskaj, udhëheqësja e Bibliotekave nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, znj. Shkurte Kadriu, drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, dr. Sali Bashota, presidentja e Shoqatës së Bibliotekave të Shqipërisë, Tefta Buzo, si dhe dr. Aurel Plasari, drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, i cili mbajti një fjalë të veçantë në këtë seancë.

Gjatë dy ditëve të Konferencës, në seancat e mbajtura kanë referuar mbi 20 përfaqësues nga Shqipëria dhe Kosova me tema nga fusha e teknologjisë së informacionit, si: roli i bibliotekave në zhvillimet e teknologjive moderne; funksioni i mediave elektronike në bibliotekat moderne; aplikimi i teknologjisë informative, përkatësisht automatizimi i shërbimeve bibliotekare dhe risitë që sjell ajo në këto shërbime, si dhe aftësimi për t'u qasur në këtë informacion. Një vend të rëndësishëm në këto referime ka pasur edhe raporti mes bibliotekave dhe institucioneve qeveritare; trajtimi institucional që u bëhet bibliotekave publike dhe nevojat që kanë ato sot për t'u rikonceptuar edhe në nivel të ruajtjes së raportit në trekëndëshin - libër, lexues, bibliotekë. Temat që kanë ekskluzivitetin e vet profesional, ishin edhe ato në fushë të kontrollit bibliografik, apo të tilla në formë idesh për hartim të bib-



liografive kombëtare shqiptare; referime që shtrojnë probleme të ekzemplarit të detyrueshëm, si dhe të copyright-it. Një pjesë e temave që janë trajtuar gjatë Konferencës ishin edhe ato që lidhen me realizime të projekteve të ndryshme dhe efektet që kanë prodhuar këto projekte të realizuara, si: implementimi i programit të automatizuar në bibliotekë, që lidhet me formimin e katalogëve online, përkatësisht konvertimin elektronik të skedarëve; formimi dhe roli i bibliotekës universitare; funksioni i Qendrës Amerikane etj.

Temat e trajtuara në këtë konferencë kanë prekur probleme të rëndësishme profesionale, si dhe sfidat me të cilat ndeshet aktualisht bibliotekaria te ne sot, në periudhën e heqjes dorë nga praktikat tradicionale bibliotekare dhe integritet në trendin e ri që po shprijnë zhvillimet e reja të

teknologjisë së informacionit.

Konferenca ka provokuar pamundësinë, që rrjedh objektivisht nga një infrastrukturë e dobët për të qarkulluar mendimi kulturor e shkencor kombëtar - i riprodhuar në material - libër, apo material elektronik, si në një 'treg' të përbashkët, por, njëkohësisht, edhe ndjeshmërinë dhe vullnetin për të provuar të gjitha mundësitë, që nëpërmjet shkëmbimit, të plotësohen interesime që kanë përdoruesit për të njëjtat vlera të përbashkëta - të traditës dhe ato moderne.

Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë ka përmbushur objektivat e para dhe ka shpërfaqur mundësi për të realizuar tash e tutje projekte të përbashkëta në fushë të arsimimit bibliotekar dhe fusha që lidhen më drejtpërdrejt me integrimet tona kulturore.

IZET ABDYLI

Bibliotekat shqiptare në botën e re demokratike

Përrurimi i një aktiviteti të tillë me karakter të përbashkët kombëtar, siç është *Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë*, themeluar nga dy institucionet më të larta të bibliotekarisë së Shqipërisë dhe të Kosovës, pra Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, gjithsesi, është një ngjarje e veçantë kulturore dhe njëra ndër datat më të rëndësishme për bibliotekarinë shqiptare në përgjithësi, e cila po kurorëzohet në fushën e bashkëpunimit, tashti edhe në nivelin shkencor.

Debati për rolin dhe misionin e bibliotekave shqiptare në botën e re demokratike përbrenda sfondit nacional, sigurisht do t'i çelë të gjitha rrugët dhe mundësitë për krijimin e një perspektive të re kulturore në shumë drejtime, natyrisht për të kontribuar edhe në alternativat e tjera dobiprurëse, sa i përket zhvillimit dhe përparimit të bibliotekarisë, kuptohet në të gjitha nivelet.

Në këtë mënyrë, të veprosh sipas kriterit institucional për të mbërritur qëllimin për një organizim të këtillë të veprimtarisë kulturore, ku fjalët më të përdorshme do të jenë: *libër*, *bibliotekë*, *lexues* apo *shkrimtar*, *botues* etj., është detyrim dhe përkushtim intelektual, për të riaktu-

alizuar fuqishëm procesin e avancimit të dijeve, koncepteve, përvojave, rezultateve në fushën e bibliotekarisë bashkëkohore, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithsesi, objektivat e kësaj *Konference* do t'i përcaktojnë vlerat e veçanta dhe interesimet e përbashkëta të specialistëve të Shqipërisë dhe të Kosovës, për t'i evidentuar dhe formuluar drejt dhe qartë faktorët që e

fondeve të veçanta të shoqërisë civile, për të kontribuar ndjeshëm edhe në demokracinë dhe në mirëqenien sociale e kombëtare, duke e ditur faktin se njëri ndër institucionet që mund të kontribuojë më së shumti në ndriçimin e kujtesës historike dhe të identitetit nacional të një kombi, është pra biblioteka, madje qoftë edhe në rrafshin e globalizmit kulturor.

Me gjithë depërtimin e teknologjive të reja të komunikimit në botën e librit, ku është ndryshuar modeli dhe koncepti i qasjes në biblioteka, pra edhe vetë kodi i lexuesit, megjithatë "ideali klasik" për librin dhe bibliotekën mbetet gjithmonë i njëjtë, dashunues dhe i pazëvendësueshëm. Siç është e njohur, libri i përmbys të gjitha kodet, sistemet, diskursat e komunikimit dhe të qarkullimit të teknologjisë moderne dhe për krijuesin e lexuesin

mbetet gjithmonë i shenjtë, vetëm aty ku e ka vendin. Pra, brenda në bibliotekë.

Tema bosht e kësaj Konference "Bibliotekat shqiptare në botën e re demokratike" përbrenda kontekstit kulturor mund të jetë një hyrje që i karakterizon fenomenet e bibliotekarisë. Më tutje, objekti i studimit më të plotë mund t'i përmbajë esencat e komunikimit në projekte të veçanta kombëtare për ndërgjegjësimin më të madh institucional dhe për një vetëdije krijuese



lëvizin dhe e përcaktojnë këtë veprimtari në fushën e hulumtimit dhe të kërkimit për bashkëpunim të ndërsjellë në shumë kahe, si dhe në nxitjen, përkrahjen, afirmimin e ideve funksionale në një shoqëri të drejtë dhe demokratike, ku libri, kultura, qytetërimi janë esenca e edukimit dhe e zhvillimit të saj. Prandaj, bibliotekat, doemos, duhet të kenë "sigurinë" e tyre kulturore me mbështetësit e fuqishëm qeveritarë, por edhe me mundësinë reale të participimit të bizneseve dhe

më të qartë, që ka të bëjë me rolin dhe misionin e bibliotekave brenda shoqërisë pluraliste dhe demokratike, madje për krijimin e një strategjie të zhvillimit të tyre në rrafshin kulturor. Dhe, kjo nuk ka ndodhur ende në Kosovë.

Gjithsesi, zgjedhja e temës së qëlluar dhe mjaft aktuale, si dhe motivimet e kontributet e studiuesve në këtë fushë, ndërliiden me rezultatet e pritura e të synuara, qoftë nga pikënisa apo përpjekja për të mbërritur te esenca e funksionalizimit të metodave bashkëkohore për qasje të lirë në burimet e bibliotekave. Këtu, natyrisht nevojitet për të sublimuar edhe dijen shkencore e kulturore, për ndriçimin e çështjeve dhe të problemeve që kanë të bëjnë me fushën e bibliotekarisë në përgjithësi dhe për modernizimin e shërbimeve efikase. Është koha dhe momenti që me rastin e organizimit të kësaj Konference, këtu sivjet në Tiranë dhe vitin e ardhshëm në Prishtinë, të sensibilizojmë opinionin publik që të sigurohen sa më shumë fonde qeveritare dhe alternative për themelimin, pasurimin, zhvillimin e bibliotekave shqiptare të të gjitha llojeve dhe në gjitha nivelet. Në Kosovë është i domosdoshëm një angazhim i përbashkët i institucioneve vendimarrëse në kapërcimin e gjendjes, jo të lakmueshme, në shumë biblioteka, duke ditur për fatin e tyre para, gjatë dhe pas luftës.

Pa dyshim, projektet e përbashkëta në iniciimin dhe zgjerimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me librin dhe bibliotekat, mbështetje kryesore do të kenë kriterin e vlerave dhe të rezultateve të dëshmuara, së pari në krijimin e stafit të aftë profesional, pastaj në pasurimin e fondeve, zhvillimin e koleksioneve, përsosmërinë e shërbimeve, bashkëpunimin ndërbibliotekar, qasjen e lirë në

informata etj., ndërsa synimi mund të projektohet dhe të shtrihet edhe më tutje, qoftë për përmirësimin e gjendjes aktuale të bibliotekave shqiptare, qoftë për modelet e funksionimit dhe të menaxhimit të tyre. Rrjedhimisht, institucionet kryesore shqiptare në Kosovë e Shqipëri, pikërisht në decenien e parë të shekullit XXI, duhet të kontribuojnë në ndërtimin e platformës dhe të strategjisë së re kulturore edhe për bibliotekat. Për më tepër, kjo veprimtari e përbashkët e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe e Bibliotekës Kombëtare dhe



Universitare të Kosovës dhe e bibliotekave të tjera, e cila mund të konsiderohet si njëra ndër veprimtaritë më të rëndësishme kulturore, lirisht mund të ketë rolin prijës për iniciimin e projekteve kapitale në zhvillimin dhe përparimin e bibliotekarisë kombëtare, madje duke hyrë edhe në rrjedhat më të avancuara të bibliotekarisë evropiane dhe amerikane.

Kosova ka hyrë në shekullin e ri kulturor me një veprimtari ndërkom-

bëtare për bibliotekat që quhet *Java e Bibliotekës në Kosovë*, e cila organizohet që nga viti 2003, në bashkëpunim me Zyren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë. Tashmë bibliotekat e Kosovës po e vazhdojnë misionin e tyre përbrenda modelit të kulturës shqiptare bashkë me bibliotekat e Shqipërisë në *Konferencën Kombëtare të Bibliotekonomisë*, duke pretenduar të krijojnë perspektivën dhe vizionin për të tashmen dhe të ardhmen e tyre.

Në fund, unë me bashkëpunëtorët e mi nga Prishtina po ndihemi shumë të nderuar me miqtë tanë këtu në

Tiranë. Ky është njëri ndër çastet më të gëzueshme për fillimin e mbarë të aktivitetit të përbashkët, që ka të bëjë me librin dhe bibliotekat, por edhe me kulturën dhe qytetërimin tonë.

(Fjalë e hapjes e Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - prof. dr. Sali Bashota, me rastin e edicionit të parë të Konferencës Kombëtare të Bibliotekonomisë, të mbajtur në Tiranë, më 20 nëntor 2006)

Poezia shqipe në Kosovë 1953-1980

(Nga historia e librit shqip)

MR. TAHIR FONIQI

Poezia shqipe e Kosovës është pjesë e letërsisë kombëtare, e cila krijohet, në kontinuitet, rreth pesë shekuj, duke u bërë, kështu, hallkë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kulturore e letrare.

POEZIA PËR TË RRRITUR

Libri i parë i poezisë shqipe, për të rritur, në Kosovë është botuar më 30 maj 1953, titulluar *Nji fyell ndër male* i poetit Martin Camaj. Sipas një dëshmie, ky libër ka qenë i gatshëm për botim në gjysmën e parë të vitit 1952. Në fund të poezisë "Këcimi", ("Jeta e re", 1952, 4, 264-265) autori ka shënuar: nga përmbledhja "*Nji fyell ndër male*". Rrjedhimisht viti 1953 paraqet datë me rëndësi historike të ne për këtë gjini letrare.

Vëllimi poetik *Nji fyell ndër male* ka 18 poezi: *Fyellit, Katundi, Qarri, Mokna, Kroni, Luli, Fëmija i malit, Në dimën, Nana, Në pranverë, Mbramja, Zana, Gjarpni, Këcimi, Nata në mal, Në verime, Roja, Barit, Amaneti i dashnorit, Moj e mira, Nana e djali, Kush asht ma i forti, Kah vrrijet, Gjethi bjen, Dhimba e Zanës, Ditë vjeshte, Java e mbramë dhe Ikja*.

Ky vëllim ka 1132 vargje strofash tri, katër, pesë e gjashtë vargjesh, rimash të ndryshme. Është botuar në 2000 kopje, në format 20 x 10 cm. Libri ka parathënien nga prof. V. Dançetoviq. Në librin *Nji fyell ndër male*, Camaj "ka shkri në një riljev artistik çdo gja t'ambientit: katundin, malet pitoreske me hije e tuba dhe çka asht ma me randësi dashnin në zemrën malsore".

Më 1954 Martin Camaj boton edhe librin tjetër me poezi për të rritur *Kanga e vërrinit*, që është vazhdimësi tematike e artistike e poetit Camaj për Dukagjinin e njerëzit e tij, ku hetohet



po ai zë origjinal e frymëzues i poetit. Këto dy përmbledhje poezish nuk kanë pasur ribotime gjatë periudhës në shqyrtim, ndonëse ato kanë pasur ndikim të ndjeshëm në rrjedhat e poezisë sonë për të rritur në Kosovë e më gjerë.

Dhjetëvjetëshi i parë 1953-1963. - Gjatë këtij dhjetëvjetëshi janë botuar 17 tituj të dymbëdhjetë poetëve. Janë botuar *Nji fyell ndër male* e *Kanga e vërrinit* e Martin Camajt, *Për ty* e Esad Mekulit, *Tufa* e Latif Berishës, *Gjurmata e jetës* e *Bebzat e mallit* e Enver Gjerqeku, *Zani i malit* e *Buzëqeshjet e mesditës* e Murat Isakut, *Bulzat* e Azem Shkrelit, *Drita në zemër* e Adem Gajtani, *Pëshpëritjet e mëngjezit* e Fahredin Gungës, *Në krahët e shkrepave* e Din Mehmetit, *Thirrje* e *Shamijata e përshëndetjeve* e Ali Podrimjes, *Me sy kange* e Rahman Dedajt dhe *Vetëm jehona* e Ali Musajt. Tetë poetë kanë botuar nga 1 titull: Esad Mekuli, Latif Berisha, Azem Shkrelit, Adem Gajtani, Fahredin Gunga, Din Mehmeti, Rahman Dedaj e Ali Musaj. Ndërsa, katër poetë kanë botuar nga 2 tituj:

Martin Camaj, Enver Gjerqeku, Murat Isaku e Ali Podrimja. Këto botime përbejnë 1156 faqe në tirazh 51000 kopje. Titujt kanë pasur këtë rrjedhë të botimit: më 1953, 1954, 1955 e 1962 është botuar nga 1 titull, më 1957-2, 1960-3 e më 1961 e 1963 botohen nga 4 tituj. Kurse më 1956, 1958 e 1959 nuk është botuar asnjë titull. Titujt i kanë botuar Rilindja, revista letrare "Jeta e re" etj.

Dhjetëvjetëshi i dytë 1964-1974. - Në këtë dhjetëvjetësh botohen 118 tituj poezie të 63 poetëve: Azem Shkrelit, Bedri Hysa, Besim Bokshi, Esad Mekuli, Fahredin Gunga, Josip Rela, Mark Krasniqi, Milaim Berisha, Mirko Gashi, Nexhat Pustina, Rexhep Elmazi, Teki Dervishi, Shime Deshpali, Sabri Hamiti, Nebih Muriqi, Rifat Kukaj, Rahman Dedaj, Musa Ramadani, Adem Gajtani, Enver Gjerqeku, Eqrem Basha, Qerim Ujkani, Jakup Ceraja, Abdylaziz Islami, Din Mehmeti, Muhamed Kërveshi, Beqir Musliu, Ali Podrimja etj. Prej këtyre, tridhjetë e gjashtë poetë kanë botuar nga 1 libër, njëmbëdhjetë - nga 2, tetë - nga 3, pesë - nga 4 dhe tre - nga 5: Ali Podrimja, Beqir Musliu e Muhamed Kërveshi. Gjatë këtij dhjetëvjetëshi botohen edhe përmbledhjet e para të katër poeteshave: *Dallgë zemrash* e Sadete Emërllahut, *Sonte zemra ime feston* e Edi Shukriut, *Verma emrin tim* e Flora Brovinës dhe *Një mijë e një lule* e Sheherzade Shkrelit. Titujt janë botuar në Rilindja, "Jeta e re", Seksioni letrar "Jeronim De Rada" i Ferizajt, autorët, Klubi letrar "Trepça" i Mitrovicës, gazeta e studentëve "Bota e re" etj. Tirazhi i këtyre botimeve sillet rreth 230000 kopje. "Sidoqoftë, sot lirisht mund të thuhet se poezia shqipe kurrë nuk ishte më e pasur, më e degëzuar, më e gjerë në përmbajtje, më e guximshme dhe më e

llojlojshme në format e shprehjes se ç'është në këtë kohë”.

Dhjetëvjetëshi i tretë 1975-1980. - Gjatë këtyre viteve janë botuar 72 tituj të 57 poetëve: Agim Mala, Ali Olloni, Agim Deva, Frrok Kristaj, Idriz Ulaj, Isak Ahmeti, Ismet Hebibi, Jusuf Gërvalla, Kadri Kadriu, Abdullah Konushevci, Merrushe Gjoshaj, Misret Halili, Murat Isaku, Nexhat Halimi, Osman R. Gashi, Ramadan Mehmeti, Rexhep Ferri, Rustem Berisha, Skënder Sherifi, Shaip Beqiri, Qerim Ujkani, Mehmet Hoxha, Demë Topalli, Ymer Shkreli, Adem Gashi, Ibrahim Kadriu, Nehas Sopaj, Nexhmedin Soba etj. Prej këtyre, dyzet e pesë poetë kanë botuar nga 1 libër, nëntë - nga 2 dhe tre - nga 3: Bedri Hysa, Enver Gjerqeku e Muhamed Kërveshi. Librat i kanë botuar kryesisht Rilindja, revista “Jeta e re” e klubet letrare. Tirazhi i këtyre botimeve silleth rreth 126000 kopje.

Gjatë kësaj periudhe botohen edhe titujt e parë me shkrimin në Braj, si Vjersha të Esad Mekulit, titulli *Vëpra* e Migjenit, *Thikë harrimi* e Sabri Hamitit, *Lumi i palodhur* i Enver Gjerqekut, *Jeta gabon* e Rrahman Dedajt, *Panorama e poezisë shqipe* etj. Titujt me këtë shkrim janë shtypur në 15 - 150 kopje.

Me një fjalë, gjatë periudhës kohore 1953-1980 janë botuar 207 tituj me poezi për të rritur, të krijuar prej 132 poetëve. Tirazhi i këtyre botimeve silleth rreth 407000 kopje.

Gjatë periudhës 1953 - 1980 poetët tanë, krahas vjershës e kanë krijuar edhe poemën: Martin Camaj, Esad Mekuli, Azem Shkreli, Besim Bokshi, Ali Podrimja, Fahredin Gunga, Din Mehmeti, përkatësisht kurorën sonetike: Enver Gjerqeku, Abdylaziz Islami, Beqir Musliu, Hasan Hasani, Demir Behluli etj.

Për më kureshtarët sjellim këtu edhe këtë të dhënë: gjatë periudhës kohore 1953-1980, për 27 vjet krijimtari letrare në këtë gjini, në titujt e përmendur, janë botuar rreth 393000 vargje për të rritur.



POEZIA PËR FËMIJË

Krahas poezisë për të rritur, paralelisht, në Kosovë është krijuar edhe poezia për fëmijë e cila, në formë të librit, botohet që nga 1953, duke filluar me dy titujt e parë: *Gjethet e reja* (vjersha për fëmijë) të Rexhep Hoxhës e *Prrallat e gjyshit* të Mark Krasniqit. Kështu, Rexhep Hoxha e Mark Krasniqi janë poetët, që botuan librat e parë me poezi për fëmijë në Kosovë.

Sipas hulumtimeve tona, vëllimi poetik *Gjethet e reja* është libri i parë i poezisë për fëmijë, i botuar në Kosovë në shtator 1953. Ndërkaq, vëllimi *Prrallat e gjyshit* i Mark Krasniqit është botuar në tetor 1953. Libri *Gjethet e reja* i Rexhep Hoxhës ka 44 poezi motivesh, temash, strofash e rimash të ndryshme.

Dhjetëvjetëshi i parë 1953-1963. - Gjatë këtij dhjetëvjetëshi janë botuar 10 tituj me poezi për fëmijë të pesë poetëve: Rexhep Hoxha, Mark Krasniqi, Anton Çetta, Vehbi Kikaj e Maksut Shehu. Tre poetë kanë botuar nga 1 libër: Anton Çetta, Maksut Shehu e Vehbi Kikaj, një - 3: Mark Krasniqi, e një poet boton 4 libra: Rexhep Hoxha. Librat i ka botuar Shtëpia botuese “Mustafa Bakija”, përkatësisht Rilindja e Prishtinës dhe rrokin 667 faqe në 27200 kopje.

Dhjetëvjetëshi i dytë 1964-1974. - Në këtë dhjetëvjetësh botohen 65 tituj librash me poezi për fëmijë nga tridhjetë e tetë poetë: Qamil Batalli, Hivzi Sulejmani, Zihni Sako, Rrahman Dedaj, Odhise Grillo, Esad Mekuli, Ymer Shkreli, Ramadan Pasmaqiu, Naim Morina, Rushit Ramabaja, Bedri Rama, Anton Berisha, Nuhi Vinca, Ibrahim Kadriu, Mehmedali Hoxha, Abdylaziz Islami, Zejnullah Halili, Avdi Shala, Ymer Elshani, Ali Huruglica, Rifat Kukaj, Muhamed Kërveshi, Agim Deva, Alqi Kristo, Qerim Ujkani, Nuhi Veselaj etj. Prej këtyre, njëzet e katër poetë kanë botuar - nga 1 libër, dhjetë - nga 2, një - 3, dy - nga 4 e një poet boton 6 tituj: Agim Deva. Janë botuar edhe disa tituj grup autorësh, si *Letër pranverës*, Prishtinë, 1965, *Këndo vlla*, Prishtinë, 1966 etj. Librat i ka botuar kryesisht Redaksia e botimeve Rilindja. Botimet rrokin 4895 faqe në 186100 kopje.

Dhjetëvjetëshi i tretë 1975-1980. - Gjatë këtyre viteve botohen 37 tituj librash me poezi për fëmijë nga 24 poetë: Adelina Mamaqi, Gani Xhafolli, Shpresa Vinca, Hasan Hasani, Fejzi Bojku, Nol Berisha, Jakup Çitaku, Lutfi Lepaja, Faruk Tasholli, Mehmet Haziri, Xhevat Sylja, Ibrahim Shala, Ramadan Zejneli, Qani Shabani, Aziz Ruhani etj. Gjashtëmbëdhjetë poetë kanë botuar nga 1 libër, pesë - nga 2, një - 3 e dy poetë botojnë nga 4 tituj: Rexhep Hoxha e Agim Deva. Librat i kanë botuar Rilindja e Prishtinës, Seksioni letrar “De Rada” i Ferizajt etj. Titujt rrokin 2465 faqe dhe janë botuar në 67500 kopje.

Me një fjalë, gjatë periudhës 1953-1980, në Kosovë, janë botuar 112 libra me poezi për fëmijë: vjersha, poema, poema përrallë, tregime në vargje, përralla në vargje, pjesë teatrale në vargje etj. Këto botime rrokin 8027 faqe ose 502 tabakë shtypi në tirazh rreth 280500 kopje.

FORMATI MARC: TË KUPTUARIT E NJËSIVE BIBLIOGRAFIKE

Terminologjia e formatit MARC dhe definicionet e tyre

(vijon nga numri i kaluar)

Kjo pjesë ka të bëjë me atë se si t'i lexojmë, t'i kuptojmë dhe t'i përdorim njësitë në formatin MARC. Ka të bëjë me atë se çfarë shohin bibliotekarët në ekranin e kompjuterit të tyre gjatë përdorimit të një sistemi të automatizuar me rastin e krijimit, redaktimit apo kontrollimit të njësisive bibliografike. Një theks i veçantë do t'u kushtohet atyre fushave, të cilat përdoren më së shpeshti për të kataloguar materiale për bibliotekat e vogla shkollore dhe ato publike, d.m.th. të materialeve libra dhe audio-vizuele. Megjithatë, ajo që shtjellohet në këtë pjesë zbatohet në tërësi për të gjitha format e materialeve, duke përfshirë incizimet zanore, programet kompjuterike, hartat dhe njësitë e tjera jolibër.

Ndryshimet e miratuara së voni, disa prej të cilave tashmë janë vënë në jetë, në formatin MARC, për njësitë bibliografike, përfshijnë edhe konceptin "integrim formatesh". Me termin "integrim formatesh" nënkuptohet përdorimi i njësuar i "shenjave orientuese" për t'i shënuar të dhënat në njësi bibliografike për të gjitha llojet e materialeve sesa të përdoren grupe të ndryshme të "shenjave orientuese" për secilin grup të llojeve të materialeve.

Në shembullin e dhënë në numrin e kaluar të revistës (në fq. 10) është paraqitur një njësi në formatin MARC e etiketuar me "shenjat orientuese". Emri i duhur i këtyre "shenjave orientuese" do të ishte: *fusha, tagu, treguesi, nënfusha, kodet e*

nënfushave dhe treguesit e përmbajtjes. Kjo terminologji e formatit MARC 21 është shtjelluar në këtë pjesë.

I. FUSHAT JANË TË SHËNJUARA ME TAGE

Fusha: Secila njësi bibliografike është e ndarë në mënyrë logjike nëpër fusha. Ekziston një fushë e veçantë për autorin, një fushë për informacionin e titullit, e kështu më radhë. Këto fusha janë të ndara në një apo më shumë "nënfusha".

Siç e kemi përmendur edhe më herët, emrat e fushave në formë tekstuale janë shumë të gjata për t'u riprodhuar në secilën prej fushave të njësisive në formatin MARC. Kështu që ato zëvendësohen me një tag tre-shifror. (Edhe pse katalogët në Internet mund t'i shfaqin edhe emrat e fushave në formë tekstuale, ato mundësohen nga softveri e jo nga njësitë bibliografike në formatin MARC).

Tagu: Secila fushë shoqërohet me një numër tre-shifror të quajtur "tag". Tagu e identifikon fushën – llojin e informacionit – që pason. Tagu paraqitet gjithmonë me tre numrat e parë, edhe pse kompjuterët mund t'i shfaqin ata së bashku me treguesit (që mund të duket se kemi të bëjnë me një numër 4 ose 5 shifror).

Taget e përdorura më së shpeshti janë këto që pasojnë më poshtë, të cilat paraqesin:



Tagu 010 - numri i kontrollit të Bibliotekës së Kongresit;

Tagu 020 - Numri Standard Ndërkombëtar i Librit;

Tagu 100 - përcaktuesja kryesore e emrit (autorin);

Tagu 245 - informacioni i titullit (që përfshin: titullin, informacionet shtesë të titullit, si dhe personat përgjegjës të veprës);

Tagu 250 - ribotimi;

Tagu 260 - informacionet e botimit;

Tagu 300 - përshkrimi fizik;

Tagu 440 - informacioni i serisë a i koleksionit përcaktues shtesë;

Tagu 520 - vërejtjet anotuese a përmbledhëse;

Tagu 650 - përcaktuesja lëndore tematike;

Tagu 700 - përcaktues shtesë të emrit personal (bashkautor, redaktor, ose ilustrues);

Këtu po japim një shembull të një fushe. Numri 100 është një tag, i cili e përcakton këtë fushë si përcaktuesen kryesore të emrit personal.

100 1# \$a Pirsig, Robert M.

Shërbimi i shpërndarjes së njëjësive kataloguese (në origjinal: Cataloging Distribution Service, CDS) të Bibliotekës së Kongresit e mirëmban dhe e shpërndan listën e hollësishme të të gjitha tageve si në dokumentin e plotë "Formati MARC 21 për njësitë bibliografike" (në origjinal: MARC 21 Format for Bibliographic Data), si dhe në versionin e përmbledhur me titull "Formatet MARC 21" (në origjinal: MARC 21 Concise Formats). Gjatë punës me formatin MARC ju këshillojmë që t'i përdorni këto dy dokumente. Ato janë dokumente të hollësishme, të cilat përmbajnë shembuj të shumtë. Në njësitë në formatin MARC, 10% e tageve përdoren në mënyrë të pandërprerë, ndërsa pjesa tjetër prej 90% përdoret herë pas here për të mos thënë fare rrallë. Madje, pas një periudhe të shkurtër të përdorimit të formatit MARC, nuk është e pazakontë t'i dëgjojmë bibliotekarët duke folur me gjuhën e formatit MARC. Bibliotekarët që punojnë me njësitë në formatin MARC i mësojnë përmendësh numrat e fushave, të cilat janë të zakonshme për materialet, që i katalogojnë.

2. DISA PREJ FUSHAVE IDENTIFIKOHEN MË TEJ PREJ TREGUESVE

Treguesi: Dy pozita të rezervuara vijnë menjëherë pas secilit tag (me përjashtim të fushave 001 deri 009). Një ose të dy nga këto pozita mund të përdoren për t'i vendosur "treguesit". Në disa prej fushave përdoret vetëm treguesi i parë ose i dytë; në disa të tjera përdoren të dy treguesit; e në disa fusha, si fusha 020 dhe 300

nuk përdoret asnjë prej treguesve. Në ato raste kur nuk përdoren treguesit në asnjërën prej pozitave, ai tregues do të thotë se është "i papërcaktuar" dhe pozita lihet e zbrazët. Në këtë dokument do të përdorim shenjën "#" për të paraqitur një pozitë të zbrazët ose tregues të papërcaktuar.

Vlera e secilit tregues është një numër prej 0 deri 9. (Edhe pse rregullat shkruajnë se treguesi mund të jetë edhe shkronjë, ato zakonisht nuk përdoren). Edhe pse treguesit mund të duken se janë një numër i përbashkët 2-shifror, ata në të vërtetë janë dy numra të ndryshëm me vlera të pavarura nga njëri tjetri. Vlerat e treguesve dhe kuptimi i tyre është shpjeguar në dokumentacionin e formatit MARC 21. Në shembullin pasues, 3 shifrat e para paraqesin tagun (numri 245 e definojnë këtë si fusha e titullit) dhe dy shifrat pasuese (numri 1 dhe 4) janë vlerat e treguesve. Numri 1 është treguesi i parë; 4 është treguesi i dytë.

245 14 \$a The emperor's new clothes /
\$c adapted from Hans Christian Andersen
and illustrated by Janet Stevens.

Vlera e treguesit të parë "1" në fushën e titullit tregon se ekziston një përcaktuese e veçantë e titullit në katalog. Po të kishim të bënim me skeda në letër, kjo do të thoshte se do të duhej të shtypej një skedë për këtë njësi dhe një përcaktuese për "Titullin" që do t'i shtohet indeksit për kërkim. Treguesi i parë me vlerë "0" në fushën e titullit do të nënkuptonte se titulli paraqet përcaktuesen kryesore; skeda do të shtypej në formën e saj të rregulltë tradicionale pa përcaktuese të veçantë për titullin (pasi ajo është vetë përcaktuese kryesore në këtë rast).

Karakteret të cilat nuk indeksohen: Njëri prej treguesve më karakteristike është treguesi i dytë në fushën e titullit. Ai paraqet numrin e karaktereve në fillim të një fushe (përfshirë edhe hapësirat) të cilat nuk do të numëroheshin (indeksoheshin) nga kompjuteri në rast të procesit të shfletimit apo dhe renditjes së përcaktueseve në sistem. Për titullin e mësipërm "The emperor's new clothes", vërejmë se treguesi i dytë është "4", kështu që katër karakteret në fillim (shkronjat "t", "h", "e", si dhe hapësira që pason) nuk do të indeksohen nga kompjuteri dhe se titulli do të radhitet në sistem nën fjalën e parë "emperor's".

3. NËNFUSHAT IDENTIFIKOHEN ME KODE TË NËNFUSHAVE DHE DILIMETËR

Nënfusha: Shumica e fushave përmbajnë pjesë të ndryshme të informacionit të lidhura me njëra-tjetrën. Secili lloj i informacionit brenda një fushe quhet nënfushë, dhe secilës nënfushë i paraprin kodi i nënfushës. Fushat prej 001 deri 009 nuk kanë nënfusha.

Për shembull, fusha e përshkrimit fizik të një materiali libër (e përcaktuar me tagun 300) ka një nënfushë për numrin e faqeve, një nënfushë tjetër për hollësira të tjera fizike (ilustrimet), si dhe një nënfushë për dimensionet (centimetrat):

300 ## \$a 675 f. :
\$b me ilustr. ; \$c 24 cm.

Kodi i nënfushës: Kodet e nënfushave shprehen me shkronja të vogla (e nganjëherë edhe me një numër) të paraprirë prej një dilimetri. Dilimetri është një shenjë që shërben për t'i ndarë nënfushat nga njëra-tjetra. Secili kod i nënfushës tregon se çfarë lloj informacioni ka aty. (Dokumentacioni i formatit MARC 21 paraqet në formë

listash dhe i përshkruan të gjitha kodet e nënfushave për secilën fushë në formatin bibliografik).

Dilimetri: Programet e ndryshme kompjuterike përdorin shenja të ndryshme për të shfaqur dilimetrin në ekran të kompjuterit apo për të shtypur informacionin. Për shembull, përdoren shenjat (‡), (@), (\$), (_), apo edhe ndonjë shenjë tjetër. Në këtë dokument ne do të përdorim shenjën e dollarit (\$) si dilimetër që paraqet një pjesë të kodit të nënfushës.

Në shembullin e mësipërm, kodet e nënfushave janë \$a, për faqet, \$b për hollësitë e tjera fizike dhe \$c për dimensionet.

4. TREGUESIT E PËRMBAJTJES – ËSHTË NJË TERM I GJERË QË U REFEROHET TAGEVE, TREGUESVE DHE KODEVE TË NËNFUSHAVE

Të tri llojet e treguesit të përmbajtjes – taget, treguesit dhe kodet e nënfushave – janë shenjat kryesore në sistemin e shënjimimit të formatit MARC 21. Në librin e tij, *Formati MARC për përdorim në biblioteka*, botimi i dytë, f. 5 (Boston: G.K. Hall & Co., 1989) (në origjinal: MARC for Library Use), Walt Crawford e quan sistemin e formatit MARC një sistem i cili përdor “shenja-simbole”. Të tri llojet e treguesve të përmbajtjes janë shenja-simbole të shkurtra, të cilat i emërtojnë dhe i shpjegojnë njësitë bibliografike.

5. DISA RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Ekzistojnë disa rregulla të përgjithshme të cilat ndihmojnë në kuptimin e të gjithë atyre numrave të përdorur si tage të fushave. Ju lutem vëreni që në diskutimet për taget në formatin MARC 21 shenjat me të dhëna Xx do të përdoren për të shprehur një grup të përafërt tagesh. Për shembull, 1XX paraqet të gjitha taget me 100, si: 100, 110, 130 e kështu më radhë.

Taget e ndarë me qindëshe. Ndarja themelore e njëjësive bibliografike në formatin MARC 21 është:

0XX Informacioni kontrollues, numra, kode
1XX Përcaktueset kryesore
2XX Titujt, ribotimi, botimi (në përgjithësi, titulli, informacioni për personat përgjegjës, ribotimi dhe informacionet e botimit)
3XX Përshkrimi fizik etj.
4XX Informacionet për serinë a koleksioni (siç paraqitet në libër)
5XX Vërejtjet
6XX Përcaktueset shtesë lëndore
7XX Përcaktueset shtesë, përveç atyre lëndore a të serive
8XX Përcaktueset shtesë të serive (forma të tjera të autorizuara)

Fushat 9XX janë të papërcaktuara dhe ato mund të definohen për përdorim brenda një hapësire të caktuar sipas nevojave të një biblioteke. Biblioteka të caktuara, shtëpi botuese a shitës, mund t'i përcaktojnë ato fusha për t'i shënuar informacionet shtesë një njësie bibliografike. (Fushat X9X në secilin prej këtyre grupeve – 09X, 59X, etj. – janë po

ashtu të rezervuara për përdorim të brendshëm, përveç fushës 490.)

Lista e tageve më të përdorura tregon se si përshtaten secila prej tyre në këto ndarje: fusha 100 është përcaktuese kryesore për autorin; fusha 520 është për vërejtjet e përmbledhjes, e kështu më radhë.

Pikat e qasjes. Pikat e qasjes (përcaktuesja kryesore, përcaktueset shtesë lëndore, dhe përcaktueset e tjera shtesë) janë pjesë të rëndësishme të njëjësive bibliografike. Këto janë përcaktuese për të cilat krijoheshin skeda të veçanta në katalogët tradicional prej letre, dhe se tani përdoruesi apo bibliotekari mund të kërkojë me ndihmën e tyre në katalogun në Internet. Pjesa më e madhe e pikave të qasjes janë në: Fushat 1XX (Përcaktueset kryesore) Fushat 4XX (Informacionet për serinë apo koleksionin) Fushat 6XX (Përcaktueset lëndore) Fushat 7XX (Përcaktueset shtesë, përveç atyre lëndore dhe serive) Fushat 8XX (Përcaktueset shtesë të serive) Këto fusha janë të kontrolluara me anë të njëjësive të autorizuara.

Përgatiti: BESIM KOKOLLARI

(vijon në numrin e ardhshëm)

Brief Record	Subjects/Content	Full Record	MARC Tags
Tringa i/ir/ Sabri Hamit.			
LC Control Number: 8804936			
000 00603nam a2200207a 450			
001 3394288			
005 19880330002534 6			
008 880317a1983 ya c 000 0 alb			
035 __ \$ (DLC) 8804936			
906 __ \$a 7 \$b cbc \$c orgnaw \$d \$e scy \$f 19 \$g p-gmccid			
010 __ \$a 8804936			
040 __ \$a DLC \$b DLC \$c DLC			
050 00 \$a MLCS 8801247 (F)			
100 1_ \$a Hamit, Sabri			
245 10 \$a Tringa i/ir/ \$b Sabri Hamit			
260 __ \$a Prishtine \$b Rilindja, \$c 1983			
300 __ \$a 360 p. \$b post. \$c 17 cm			
490 0_ \$a Edimonia Albanise			
985 __ \$a en05 03-17-88			
991 __ \$a c-GenCol \$b MLCS 8801247 (F) \$c Copy 1 \$d BOOLE			

Rëndësia e referimeve në procesin e kërkimit të Emërtimeve Lëndore

Për ta orientuar përdoruesin të materialit i dëshiruar, rol të rëndësishëm në procesin e kërkimit luajnë edhe referimet.

Ekzistojnë tri lloje referimesh:

Shih dhe Përdoret Për (PP);
Subjekt më i gjerë (SGj) dhe
Subjekt më i ngushtë (SN);
Lidhet me subjektin (LS)
dhe Shih edhe.

Referimet Shih dhe Përdoret Për (PP)

Referimi **Shih** lidh termin e përdorur me termin e përdorur. P.sh.:

Fëmijët që nuk përshtaten **Shih**
 Fëmijët problem

D.m.th. termi “Fëmijët që nuk përshtaten” nuk përdoret, por në vend të tij përdoret termi “Fëmijët problem”, që në Tregues do të dukej:

Fëmijët problem

PP Fëmijët që nuk përshtaten
 Mandej, kjo praktikë përdoret edhe te shkurtime, te termat popullore dhe shkencorë, te format e alternuara, te emërtimet e përbëra që shprehin lidhje ndërmjet dy objekteve a koncepteve, te termat antonimë etj. P.sh:

OKB **Shih** Kombet e Bashkuara

Kombet e Bashkuara

PP OKB

Pra, aty ku është shënuar PP ai term nuk përdoret.

Referimet hierarkike SGj dhe SN

Këto referime lidhin dy ose më shumë terma që janë emërtime lëndore të përdorshme, me anë të shëni-

meve SGj (Subjekt më i Gjerë) dhe SN (Subjekt më i Ngushtë). P.sh.:

Fëmijët e paaftë

SN Fëmijët me të meta fizike
 Fëmijët me të meta mendore
 Të rinjtë e paaftë

Fëmijët me të meta fizike

SGj Fëmijët e paaftë

Fëmijët me të meta mendore

SGj Fëmijët e paaftë
 Psikiatria e fëmijëve

SN Fëmijët e vonuar nga ana mendore
 Fëmijët mësojnë me vështirësi

D.m.th. të gjithë këta terma janë të përdorshëm, vetëm se hulumtohet se cili term është më i përafërt me librin që kemi në dorë.

Referimet e ndërsjella LS (Lidhet me Subjektin)

Këta terma tregojnë lidhje ndërmjet vete, por jo hierarki. D.m.th. nuk janë të ndërvarur nga njeri tjetri. P.sh.:

Feja

LS Teologjia

Teologjia

LS Feja

Këta terma përdoren për të lidhur disiplinën me objektin e studimit, klasat e personave me fushën e veprimtarisë etj. P.sh.

Sizmologjia

LS Tërmetet LS

Tërmetet

Sizmologjia

Mjekët

LS Mjekësia LS Mjekët

Mjekësia

Referimet Shih edhe

Përdoren për të orientuar përdoruesin nga një emërtim të një grup emërtime, të cilët mund edhe të mos jenë në tregues. P.sh.:

Bimët

Shih edhe emrat e llojeve të bimëve.

Sëmundjet

Shih edhe emrat e sëmundjeve të veçanta.

Në këtë cikël të materialeve që kemi dhënë në revistën Biblioetra për Klasifikimin Lëndor në katalogët e digjitalizuar, ku janë përfshirë: *Kërkimet bibliografike, Klasifikimi, Katalogimi Lëndor dhe Indeksimi Lëndor-Funksioni i tyre, Emërtimet Lëndore, Zgjedhja e termave në Treguesin e Emërtimeve Lëndore, Emërtimet e Përbëra, Emërtimet Lëndore të shprehura me emra të përveçëm, Nënndarjet dhe Rëndësia e referimeve në procesin e kërkimit të Emërtimeve Lëndore*, është bërë përpjekje për të paraqitur informacione që tashmë aplikohen nga bibliotekarët gjatë procesit të katalogimit. Meqë përvetësimi teorik i dijes për Klasifikimin Lëndor, nënkupton njëkohësisht përdorimin e kësaj dijeje në punën e mëpastajme praktike, shpresojmë të kemi dhënë informacion që do të lehtësojë të nxënit e dijes në këtë fushë dhe aplikimin e saj në procesin e katalogimit të materialeve bibliotekare.

Përgatiti: HAZBIJE QERIQI

Sigurimi i fondeve muzikore në bibliotekë

EDONA MUNISHI - KOKOLLARI

Në një shkrim tonin të botuar më parë po në këtë revistë kemi shkruar për organizimin muzikor në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe qëllimshëm e kishim lënë mundësinë e hapur për ta shtruar temën e paevitueshme të pasurimit të Bibliotekës me fonde muzikore dhe karakterit të tyre që duhet të mblidhen e të vendosen në këtë institucion. Biblioteka nuk do të kuptimësohej me hapësira të zbrazëta, por me pasurimin e pandërprerë të materialeve, të cilat me kriteret të bibliotekarisë do të jenë në shërbim të rolit dhe të misionit të vetë që kanë mjedisin e caktuar kulturor e më gjerë. Kësaj radhe do të përpiqemi që t'ia bëjmë të njohur lexuesit po edhe përgjegjësve me kompetencat e caktuara me tërë atë çka do të ishte e nevojshme me dobi e vlerë kulturore, artistike e shkencore në fushë të muzikës e që do të duhej të vendosej në hapësirat e bibliotekës së këtij karakteri.

Ne këtu në Kosovë tashmë jemi adaptuar të jemi në pozicionin e shfrytëzuesit të përvojave të mjediseve me traditë më të gjatë kulturore. Kështu veprojmë edhe me këtë rast kur kemi të bëjmë me bibliotekarinë muzikore me karakter kombëtar. Është e qartë dhe e natyrshme kërkesa që secila teknikë moderne të jetë sa më tërheqëse dhe në shërbim të shfrytëzuesve të saj. Përveç aspektit teknik, për ta bërë një mjedis kulturor të përdorshëm për të gjithë të interesuarit lypset të respektohen shumë kriteret. Në këtë kontekst kur flasim për pjesën që i

takon muzikës kërkesat janë edhe më specifike. Tradicionalisht, bibliotekarinë muzikore e bëjnë të gjitha materialet që kanë të bëjnë me muzikën e një kulture në veçanti dhe të kulturës botërore në përgjithësi. Mirëpo, në fondet e bibliotekarisë muzikore, megjithatë, janë disa kriteret përzgjedhëse të materialeve që vendosen në bibliotekën e caktuar. Kjo përzgjedhje kushtëzohet nga faktorë të tjerë që e përcaktojnë tipin e bibliotekës, hapësirën e saj, mundësitë financiare e shumë të tjera. Nga autorë të shkrimeve e të librave për dokumentacionin muzikor në bibliotekë mësojmë se i tërë materiali i fondeve muzikore do të grupohej në dy grupe të mëdha siç është: lënda muzikore konvencionale dhe, lënda muzikore jokonvencionale. Brenda këtyre grupeve degëzohen fondet e tjera sipas karakterit dhe natyrës së tyre. Për konvencionale, merren botimet e karakterit

libër: librat, revistat për muzikën, pas-taj ato jo libra, siç janë muzikalet (notat-partiturat), programet e koncerteve, pllakatet, fotografitë, etj. Në lëndë jokonvencionale po konsiderohen të gjitha materialet e incizuara në audio ose video teknikë. Duke ia shtuar këtyre materialeve edhe përdoruesit të cilët i shfrytëzojnë ato, mbledhjen e gjerë në të gjithë hapësirën kombëtare, në radhë të parë, dhe me gjerë, si dhe kushtet e përshtatshme për ruajtjen e tyre për gjeneratat e ardhshme, mund të themi se të gjitha së bashku i japin karakterin e bibliotekës së muzikës ose sektorit të muzikës së një biblioteke kombëtare.

LËNDA E PËRGJITHSHME MUZIKORE E KA VENDIN NË BIBLIOTEKË

Sigurimi dhe pasurimi me fonde muzikore nuk i ka të kufizuara hapësirat kulturore, gjuhësore dhe popullore. Kësaj radhe vëmendjen e



përqendrojmë në grumbullimin e materialeve muzikore të hapësirës kulturore muzikore në Kosovë. Që në fillim mund të shtrohet pyetja se çfarë ka në Kosovë, materiale muzikore që mund të gjenin vend në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (po edhe në biblioteka të tjera). Për t'u përgjigjur në këtë pyetje kërkohet një kthim retrospektiv dhe në gjendjen aktuale të zhvillimit të artit dhe të kulturës muzikore në këtë mjedis.

Kjo hapësirë kulturore ka një trashëgimi të pasur etnomuzikore të shtresuar nga koha në kohë e cila paraqet vlera të veçanta të kulturës muzikore. Kjo pasuri është hulumtuar dhe studiuar në masën çfarë e kanë përkufizuar kushtet dhe rrethanat e caktuara për një aktivitet të tillë. Përveç kësaj po kjo pasuri e larmishme ka shërbyer si bazë e shëndosh dhe mbështetëse për krijimtarinë artistike të shkruar. Të dy këto lloje kulturash: ajo tradicionale popullore dhe ajo e shkruar – e kultivuar, duhet të jenë të afërta dhe të mundshme për t'i njohur më tepër mënyrat që i ofron institucioni i bibliotekës kombëtare.

Deri pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë nuk kishte asnjë institucion që do të arsimonte në mënyrë të institucionalizuar e të merrej me muzikë... Me hapjen e shkollave të muzikës dhe nivele të tjera të larta të arsimimit muzikor u krijuan rrethanat e favorshme që muzika të zhvillohej dhe të kultivohej sikur edhe në qendra të tjera evropiane. Pas viteve të pesëdhjeta të shekullit të kaluar u arsimuan muziktarë profilesh të ndryshme ndër ta edhe kompozitorë. Për gjysmë shekulli në valëvitje rrethanash politike, ekonomike e kulturore kalonte edhe arti dhe kultura muzikore. Përgjatë kësaj kohe dolën krijues të muzikës që këtij mjedisi i krijuan vepra muzikore gjinish e zhanresh të



ndryshme. Në këtë kontekst edhe pse me ndërprerje kohore u realizua një fond krijimtarie muzikore që kërkonte vëmendje dhe përkujdesje institucionale. Në institucionet çfarë ishin Shoqata e Kompozitorëve të Kosovës, botues tekstesh shkollore, produksione muzikore, etj., këtij mjedisi i ofronin lëndë muzikore: konvencionale e jokonvencionale që do të gjente vend në hapësirat e Bibliotekës. Mirëpo, kjo lëndë në masë shumë të vogël gjendet në koleksionet e BKUK-së.

Kompozitorët, shkruarit dhe studiuesit e muzikës në Kosovë kanë krijuar, botuar vepra, libra, tekste shkollore, kanë publikuar shkrime e studime në revista të ndryshme. Kompozitorët tanë kanë krijuar vepra të të gjitha formave nga këngët solo deri te opera, sonatina e pjesë të vogla instrumentale deri te simfonia. Një pjesë e konsiderueshme e krijimtarisë së kompozitorëve të Kosovës është botuar dhe gjendet në partitura të shtypura, një pjesë është në dorëshkrime ende, por ne çfarëdo forme qoftë ajo akoma nuk gjendet në raftet e BKUK-së. Një pjesë e mirë e kësaj krijimtarie deri me tash

është ekzekutuar-interpretuar në koncerte, festivale dhe shfaqje të tjera muzikore. Për këto realizime janë krijuar partiturat, janë shtypur programe, pllakata, fotografi, etj. Me kriteret e bibliotekarisë muzikore më saktësisht muzikalet si lëndë konvencionale do të ishte e domosdoshme që të gjitha këto ta kenë vendin në hapësirat e bibliotekës. Ata pak studiues etnomuzikologë e muzikologë kanë botuar vepra studimore karakteresh të ndryshme dhe ato pjesërisht mund të gjenden në Bibliotekë. Për gjysmë shekulli për nevojat e arsimimit muzikor dhe mësimin të lëndës muzikore në nivele të ndryshme të arsimimit janë botuar tekste shkollore të edukatës ose kulturës muzikore dhe për arsye të ndryshme një numër shumë i reduktuar i tyre mund të gjenden në Bibliotekë. Shkrimet, studimet mbi muzikën të publikuara në gazeta e revista mund të gjenden në ato gazeta e periodikë që janë siguruar e sistemuar në këtë institucion. Pra, pjesa e lëndës konvencionale muzikore që i takon karakterit libër mund të konstatohet se është fare pak e pranishme në BKUK.

Deri në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar në Kosovë ishte vetëm produksioni muzikor i RTK-së ku incizohej muzikë zhanresh të ndryshme kryesisht në audio-kaseta. Në pesëmbëdhjetë vjetët e fundit, sidomos në këto shtatë vjetët e pas luftës, në Kosovë ka një numër shumë të madh të produksioneve muzikore që prodhojnë lloj-lloj muzike të karakterit komercial. Disa nga kompozitorët i kanë incizuar disa nga veprat e tyre në CD. Asnjë nga prodhuesit e muzikës nuk i kanë ofruar Bibliotekës materialet e tyre edhe pse shumë prej tyre janë informuar për interesat që ka ky institucion në grumbullimin e materialeve muzikore. Mund të themi se lënda muzikore jokonvencionale (disqe, audiokasetat, CD, DVD, e incizime të tjera) gati se nuk janë fare të pranishme. Natyrisht, koleksionimi i materialeve bëhet sipas kritereve vlerësuese që mund të zënë vend në BKUK. Mbledhja dhe grumbullimi i kësaj trashëgimie kombëtare në këtë institucion do të mundësonte vënien në shfrytëzim të tyre për brezat e tanishëm si dhe ruajtjen e tyre për gjeneratat e ardhshme.

SIGURIMI I FONDEVE MUZIKORE

Bibliotekat janë institucione të hapura si për shfrytëzuesit ashtu edhe për ndihmuesit dhe ofruesit e fondeve bibliotekare. Pa i elaboruar të gjitha mundësitë e sigurimit të fondeve të ndryshme muzikore siç është blerja, dhurimi, shkëmbimi, etj., ndalemi pak më shtruar në aktivizimin e përgjegjësve që mund ta kenë individët, institucionet që krijojnë, prodhojnë e publikojnë materiale muzikore të karaktereve të ndryshme.

Pa u ndalur në shkaqet dhe pa e arsyetuar varfërinë e pranisë së lëndës muzikore në BKUK, qëllimi i këtij shkrimi do të ishte ndërgjegjësimi i të gjitha seg-

menteve individuale, kolektive që do të ndihmonin në sjelljen e fondeve dhe lëndës muzikore të të gjitha formave të realizimit në Bibliotekë. Këtu edhe përkujtojmë Ligjin për Bibliotekat të miratuar nga Kuvendi i Kosovës i cili obligon qartazi të gjithë botuesit (të përbashkët apo individualë) të Kosovës t'ia sjellin BKUK-së nga pesë kopje të botimeve të tyre me qëllim të ruajtjes së tyre për brezat e ardhshëm. Për dallim nga botuesit e materialeve libra të karakterit të përgjithshëm kosovar, të cilët iu kanë përgjigjur këtij ligji deri në një

PËRFUNDIM

Angazhimi dhe përpjekjet për ta pasuruar BKUK-në me fonde muzikore kombëtare po edhe të asaj ndërkombëtare duhet të jetë permanent. Kjo mund të arrihet me angazhimin e punonjësve në Bibliotekë po gjithsesi të ndihmuar e mbështetur nga kompetentë që kanë mundësitë e ndihmesës. Po ashtu, në koleksionimin e lëndës muzikore kontribut të madh mund të japin edhe vetë autorët-kompozitorët e krijimtarisë muzikore, shtëpitë muzikore të cilët për nevo-



masë, botuesit e materialeve muzikore qoftë atyre konvencionale e atyre jokonvencionale, thuajse, ky ligj nuk ekziston fare për ta. Prandaj, ftohen kompozitorët dhe botuesit e tjerë që dorëshkrimet e tyre, partiturat e shtypura, incizimet e veprave do të ishte me interes edhe të bibliotekës po edhe të vetë kompozitorëve të gjendeshin të vendosura dhe në mundësi për nevojat e përdoruesve.

jat e bibliotekës do të ofronin numrin e caktuar të ekzemplarëve të formave të ndryshme. Kjo do të ishte në dobi të shumanshme si për autorët, kompozitorët, shtëpitë muzikore e botuese, për nevojat e bibliotekës, si dhe për ruajtjen e kësaj pasurie për brezat e ardhshëm që përbëjnë njërin ndër segmentet më të rëndësishme të veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare dhe

Shërbimi i bibliotekave shkollore

HAJRIJE PESHKU

Përcaktimi i parimeve bashkëkohore të punës me lexues, janë rezultat i kërkimeve të shumta për të gjetur format më të përshtatshme të komunikimit të lexuesit me librin (materialin bibliotekar). Në kontekstin kur bëhet fjalë për bibliotekat shkollore, një ndër kërkesat themelore është që koha dhe puna që zhvillohet aty t'u përshtatet nxënësve me qëllim që ata të fitojnë shprehitë për t'u shoqëruar me librin dhe libri të jetë gjithmonë i pranishëm në jetën e tyre.

Bibliotekat shkollore duhet t'ua mundësojnë nxënësve (përdoruesve) kontaktin e drejtpërdrejtë me librin, sipas parimit "zgjedhje e lirë". Për arritjen e kësaj, roli i katalogut është i domosdoshëm. Ndërsa, kur është fjala për lexuesit e vegjël dhe fillestarët, shfrytëzimi i fondit librar bëhet drejtpërdrejt nga raftet me zgjedhjen e lirë të vetë lexuesve. Fëmijët e moshës së re, kryesisht orientohen për librat e ilustruar, të cilat u duken më interesante. Ata presin nga librari një sqarim të shkurtër dhe preciz, por edhe përgjigje për pyetjet dhe interesimin e tyre. Edhe fabulat kanë një rëndësi të veçantë në këtë moshë të fëmijëve. Fëmija ka kërkesa të lexojë histori fabulash komike, zbavitëse e të çuditshme; diç për kafshët, por edhe për të panjohurën, që i bën ata të argëtohen, por dhe të fitojnë njohuri nga informacionet që bart teksti.

Gjersa fëmijët ta mësojnë teknikën

e të shkruarit, është e nevojshme që librari ta bëjë leximin dhe komentimin me zë, në sallën e leximit. Rekomandimi i katalogut ilustrativ do të ishte i mirëseardhur. Kështu, fëmijët bëhen vërtet lexues, që do të dinë të orientohen për të përzgjedhur literaturën që iu përgjigjet. Rol me rëndësi në këtë periudhë kanë mësuesit dhe arsimtarët e gjuhës, të cilët i orientojnë nxënësit për lekturën shkollore, sipas planprogramit të përcaktuar mësimor. Më vonë, lexuesit përcaktohen edhe për literaturë shkencore të popullarizuar, e cila përfshin të gjitha lëmitë mësimore. Kur në raftet e bibliotekave, përveç tregimeve, përrallave, poezive e romaneve, lexuesi gjen edhe literaturë tjetër: dituri natyrore e shoqërore, ndodhi nga e kaluara, histori, të arriturat shkencore - fantastike, pra, kur lexuesi njihet me numër sa më të madh të veprave, atëherë ai nis që përfundimisht të jetë i lidhur ngushtë me bibliotekën, madje gjatë gjithë jetës. Për t'u aplikuar këto forma, bibliotekat shkollore duhet të kenë fond të larmishëm të koleksioneve, sallën e leximit dhe orenditë e tjera të nevojshme, që puna me lexues të jetë sa me bashkëkohore dhe e përshtatshme.

Duke mos i marrë në konsiderim vështirësitë objektive nëpër shkollat tona, duhet angazhuar (librarian, drejtorin, pedagogun) maksimalisht që bibliotekat shkollore të kenë së paku një lokal me madhësi që plotëson nevojat e nxënësve. Për bibliotekë duhet paraparë dy kthi-

na: një më të vogël, për punën e librarit dhe një tjetër, për koleksionet dhe për lexuesit. Këto dy kthina a lokale duhet të jenë të përshtatshme dhe estetike që të zgjojnë te lexuesit shprehinë për të bukurën, që të zgjojnë kureshtjen për të mësuar dhe lexuar në atë ambient. Ato duhet të kenë ndriçim, muret të jenë të ngjyrosura me ngjyra pastelina, këndet e lira nëpër raftet të librave të jenë të stolitura më punëdoret e fëmijëve: ilustrime nga librat e lexuara, figura të gdhendura nga personazhet e përrallave, të stripeve, ndonjë vazo me lule etj. Tërë kjo kontribuon që të ngjallet atmosfera në bibliotekë dhe lexuesi të reflektojë edhe për të bukurën në literaturë dhe në jetë. Kështu, lexuesi, qëndrimin në bibliotekë dhe të lexuarit do ta pranojë si një dhuratë të çmuar dhe të dobishme.

Tani në kohën e kompjuterizimit, edhe bibliotekat shkollore duhet ta zhvillojnë veprimtarinë bibliotekare në përputhje me trendet e reja që dalin nga fusha e teknologjisë informative, duhet të investohet që bibliotekat të ecin në hap me kohën. Të bëhet trajnimi i bibliotekarëve që punojnë në biblioteka shkollore, të vizitohen vende ku aplikohen përvoja të reja të punës me fëmijë dhe të barten ato përvoja e njohuri te ne. Fëmijët i duan ndryshimet, kureshtja e tyre është shumë e gjallë dhe duan të dinë çdo gjë, ndërsa bibliotekari duhet të jetë ai që do të jetë i gatshëm të japë përgjigjen e duhur për çdo pyetje të fëmijëve.

Ndryshimet në strukturën e ISBN-së

Që nga fillimi i punës më 1970, Numri Ndërkombëtar i Standardizuar i Librit (ISBN) ka qenë i organizuar si sistem ndërkombëtar i identifikimit për industrinë e botimeve dhe tregtinë e librit. Një ISBN shoqëron një botim monografik (libër) nga prodhimi i saj e tutje deri te furnizimi dhe shpërndarja e tij.

Sistemi i ISBN-së shërben si element kyç i porosisë dhe i sistemit të inventarizimit për botuesit, shitësit dhe bibliotekat. ISBN-ja është bazë për mbledhjen e të dhënave për botimet e reja të librave, kudo në tregtinë e librit. Përdorimi i ISBN-së, gjithashtu, lehtëson menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave të shitjes në industrinë e librit.

Versioni i ripunuar i ISO-s 2108 (International Organization for Standardization), i publikuar me 2005, prezanton ndryshimin e parë të bërë në strukturën e ISBN-së që nga fillimi i përdorimit të tij dhe ky ndryshim shpie në zgjerimin e numrit nga 10-shifror në 13-shifror. Data e implementimit të ISBN-së 13-shifror në gjithë botën është 1 janari i vitit 2007.

ISBN-të ekzistues do të marrin prefiksion 978;

Si rezultat ISBN-13 shifrorë do të jetë identik me numrin EAN-13 që aktualisht kodohet në barkod;



979 prefiksi do të futet në përdorim kur fondi i tanishëm i numrave të jetë i shterur;

Prefiksi identifikues për botuesin nuk ka mundësi të mbetet i njëjti për ISBN-të me 979 prefiksion;

Barcode-t do të bartin ISBN-në 13-shifror, vendosur mbi simbolin e barkodit, me viza ndarëse, i cili do të jetë numër identik me numrin e barkodit të vendosur nën simbolin e barkodit.

STRUKTURA E NUMRIT (ISBN)

ISBN i ri përbëhet nga 13 shifra: tri shifrat e para që do t'i shtohen 10-shifrorit që aktualisht është në përdorim, përbëjnë prefiksion që

identifikon industrinë e librit (aktualisht 978). Nevoja për ndryshimin e strukturës së ISBN-së lindi sepse furnizimi me ISBN po has në një rritje të madhe të numrit të botuesve dhe si rrjedhojë edhe të botimeve në gjithë botën. Në këtë mënyrë, që nga janari i vitit 2007, industria e librit do të mund të përdor prefiksion shtesë EAN (European Article Number) 979. Kur Agjencionet e ISBN-së, në disa pjesë të botës, kanë harxhuar numrat që u janë rezervuar, ata janë të autorizuar të japin numrat me prefiksion 979. Ka mundësi që në bazë të radhitjes së botuesve, një agjencion mund të ndaj disa ISBN me prefiksion 978 dhe të tjerët me prefiksion 979.

MOMENTI I FUTJES NË PËRDORIM I ISBN-së 13-SHIFROR

Botuesit tani duhet të lëvizin drejt vendosjes të 13-shifrorit në librat e tyre sa më shpejt që është e mundur, së bashku me ISBN-në 10-shifror deri në fillim të vitit 2007. Rekomandohet që, nëse merret ky vendim, numrat duhet të përgatiten në këtë mënyrë nëse libri nuk bart barkod:

ISBN-13: 978-9951-07-020-1

ISBN-10: 9951-07-020-5

Kjo do të japë mundësi që 10-shifrori të fshihet fare, nëse botuesi do ta rishtypë librin pas 1 janarit të vitit 2007, ndërsa 13-shifrori i atij libri do të jetë ISBN valid.

Për titujt që botohen pas 1 janarit të vitit 2007, ky lloj numërimi do të kthehet në vetëm 13- shifrorin:

ISBN-13: 978-9951-07-020-1

Në rastet kur libri bart barkod, simboli i barkodit në kopertinën e fundit të librit do të jetë i pandryshuar, përveç kur *eye-readable nubre* (lexuesi i numrit) do të ndryshojë plotësisht për titujt e botuar pas 1



Barkodi me eye-readable (lexues) ISBN 13-shifror

janarit të vitit 2007 në 13-shifror, duke i paraprirë shkronjat ISBN të shkruara ashtu që të jenë lehtë të lexueshme. Botuesit që përdorin softuerët e tyre për të krijuar barkodin, duhet të sigurohen mirë që ai u është adaptuar këtyre kërkesave.

Gjatë periudhës para vitit 2007, botuesit duhet të vazhdojnë të shtypin vetëm 10-shifrorin në *eye-readable text* (lexues të tekstit) mbi simbolin e barkodit, në kopertinën e prapme të librit edhe pse ata kanë shtypur të dy numrat 10-shifrorin dhe 13- shifrorin në anën e prapme të faqes së titullit

Botuesit do të jenë të përkrahur fuqishëm të bëjnë konvertimin e detyrueshëm në ISBN 13-shifror jo më vonë se 1 janari i vitit 2007.

Sistemet teknike duhet të jenë të gatshëm të përdorin ISBN 13-shifror nga 1 janari i vitit 2007 për t'u siguruar se komunikimet me partnerët tregtarë do të vazhdojnë pa ndërprerë.

EFEKTET E KËTIJ NDRYSHIMI

Secili që është brenda rrjetit të ISBN-së është i prekur nga ky ndryshim në shkallë të caktuar. Të gjithë botuesit janë të prekur, në mënyrë të

barabartë, ashtu si edhe distributorët, bibliotekat dhe të tjerët, të cilët regjistrojnë dhe fusin ISBN-në në sistemet e tyre të automatizuara. Prandaj, konvertimi në 13-shifror fillimisht prek sistemet e automatizuara të të gjithë atyre që janë brenda këtij rrjeti e kjo nënkupton edhe sistemet e katalogimit të librit. Të gjitha agjencionet që kanë të bëjnë me ISBN-në duhet të rishikojnë sistemet e tyre – manuale dhe elektronike, sa më shpejt që është e mundur; të zhvillojnë një plan veprimi në mënyrë që të jenë të sigurt që sistemet e tyre të mund t'i përshtaten 13-shifrorit sa më mirë, deri në datën e implementimit të plotë. (Kjo do të thotë që të emërohet një përgjegjës për ekzekutimin e këtyre ndryshimeve të domosdoshme në të gjitha fushat relevante).

Në këtë kontekst, bibliotekat do ta kenë nevojë të rishikojnë funksionimin e:

Sistemit të pasurimit (rrjetin e botuesve dhe të shitësve);

Katalogimin dhe të tjerat forma të të dhënave bibliografike që futen në sistem (nëse ka);

Skanerët e barkodeve;

OPAC-un (katalogun lokal) etj.

Përgatiti: LAVDIE RRAHMANI




ISBN- 10-shifrori duket kështu kur është pjesë e 13-shifrorit në barkod

Kujtesa vegjetale dhe minerale: e ardhmja e librit

(Qyteti i Aleksandrisë e ka luajtur rolin e mikpritësit për dijetarin dhe romancierin italian, Umberto Eko, i cili më këtë rast e ka mbajtur një ligjëratë në gjuhën angleze, ku ka folur për kujtesën në nivelin letrar, por edhe gjeografik, në Bibliotekën e Re të Aleksandrisë. Javorja "Al-Ahram" e ka botuar ligjëratën e tij, të cilën po e sjellim në shqip për revistën "Biblioetra".)

NE KEMI TRI TIPE TË KUJTESËS. E para prej tyre është ajo që konsiderohet organike, e cila është kujtesë që përbëhet nga mishi dhe gjaku dhe që si e tillë administrohet nga truri jonë. Kujtesa e dytë është minerale, dhe në këtë kuptim njerëzimi ka njohur dy lloje të kujtesës minerale: para shumë kohësh kjo ishte një kujtesë që përfaqësohej nga tabelat e argjilit dhe nga obeliskët, të cilët janë shumë të njohur në këtë vend, në të cilët njerëzit kanë gdhendur tekstet e tyre. Megjithatë, ky tip i dytë është edhe kujtesa elektronike e kompjuterëve të sotëm, e cila për bazë e ka silikonin. Ne gjithashtu e njohim edhe një lloj tjetër të kujtesës, atë vegjetale, e cila përfaqësohet nga papiruset e para, pra të themi shumë të njohura në këtë vend, dhe pas kësaj të librave, të përbëra nga letra. Më lejoni, më këtë rast, ta anashkaloj faktin se në një moment të caktuar volumi i kodikëve ka qenë i një



origjine organike si dhe faktin se letra e parë është përpunuar me qilima e jo nga druri. Më lejoni të flas pra për kujtesën vegjetale me qëllim që ta përcaktojmë më shumë punën e librit.

Ky vend ka qenë në të kaluarën, dhe do të jetë edhe në të ardhmen, i përkushtuar në konservimin (ruajtjen) e librave; prandaj është dhe do të jetë një tempull i kujtesës vegjetale. Bibliotekat, përgjatë shekujve, kanë qenë rrugët më të rëndësishme për ta mbajtur gjallë dijen tonë të përgjithshme. Ato kanë qenë dhe ende janë një lloj i trurit universal ku ne mund të rikujtojmë atë që e kemi harruar, por edhe të mësojmë atë që ende nuk e dimë. Nëse do të më lejoni ta përdor një metaforë të tillë mund të them se

biblioteka është imitimi më i mirë i mundshëm, nga qeniet njerëzore, i mendjes hyjnore, ku i gjithë universi duket dhe kuptohet në të njëjtën kohë. Personi i cili do të jetë në gjendje të ruajë në mendjen e tij informacionin që sigurohet nga një bibliotekë e madhe në njëfarë mënyre do ta përmbledh edhe mendjen e Zotit. Me fjalë të tjera, ne i kemi themeluar bibliotekat, sepse ne e dimë se nuk e kemi fuqinë hyjnore, por ne bëjmë ç'është e mundur ta imitojmë atë. Të ndërtosh, ose thënë më mirë të rindërtosh, sot njërën nga bibliotekat më të mëdha në botë, mund të tingëllojë si sfidë, por edhe si provokim. Kjo ndodh sepse në mënyrë të përsëritur në disa gazeta, por edhe në trajtesa akademike, disa autorë, duke u

përballur me epokën e kompjuterit dhe internetit, flasin për mundësinë e “vdekjes së librave”. Megjithatë, edhe po të zhdukeshin librat, siç janë mënjanuar tashmë obeliskët dhe tabelat e argjilit, të cilat kanë qenë pjesë e civilizimeve antike, kjo nuk do të duhej të merrej si arsye për t’i braktisur bibliotekat. Në të kundërtën; sepse ato do të duhej të mbijetonin si muzeume që konservojnë të arriturat e së kaluarës, thuajse në të njëjtën mënyrë ashtu siç e konservojmë edhe Gurin Roseta në muze, përderisa nuk jemi mësuar të shkruajmë dokumentet tona në sipërfaqe minereale.

Por, ende, çmimi apo respekti im për bibliotekat është më i madh dhe më optimist. Unë u përkas njerëzve, të cilët ende besojnë se librat e shtypura kanë të ardhme dhe se frikësimet *à propos* për zhdukjen e tyre janë vetëm njëri nga shembujt e fundit të këtyre frikësimeve të vazhdueshme apo edhe i terroreve mijëvjeçare për zhdukjen e diçkaje, të cilat bota i ka përfshirë në vetvete.

Gjatë një kursi të shumë intervistave kam qenë i obliguar të përgjigjem në pyetjet e llojit: “A do t’i bëjnë mediat e reja elektronike librat të papërdorshme? A do ta bëjë Webi (Rjeti) literaturën të papërdorshme? A do të arrijë civilizimi i ri hipertekstual ta eliminojë idenë e autorësisë?”. Siç po e shihni edhe ju, nëse keni një mendje normale dhe të balancuar hetoni se këto janë pyetje të ndryshme dhe, duke e marrë parasysh edhe mënyrën se si janë shtruar, dikush do të mendojë se intervistuesi me këtë rast do të ndihej i sigurt se përgjigja juaj do të jetë “Jo, rri rehat, gjithçka është në rregull”. Kjo është gabim. T’u thuash këtyre njerëzve se librat, literatura, autorësia nuk do të zhduket ata do të duken të mërzitur. Por, atëherë, ku është

nyja? Ta botosh lajmin se një fitues i Çmimit Nobël ka vdekur është lajm; të thuash se ai është gjallë dhe shëndosh e mirë nuk i intereson thuajse askujt - përveç atij vetë - mendoj unë.

AJO SE ÇKA PO DËSHIROJ TË BËJ SOT është përpjekja që të shtroj pëlhurën e qasjeve të përthyerat për probleme thuajse të ndryshme. Nëse i qartësojmë idetë tona për këto probleme të ndryshme gjithashtu na mundësohet që më mirë të kuptojmë se çka zakonisht ne mendojmë me libër, tekst, letërsi, interpretim e kështu me radhë. Pra, ju do të shihni se si nga pyetja mund të prodhohen edhe shumë përgjigje të mençura, sepse ndoshta ky është edhe funksioni kulturor i intervistave naive.

Le të fillojmë me një rrëfim egjiptian, edhe pse si i tillë është treguar nga një grek. Sipas Platonit në veprën *Fedri*, kur Hermesi apo Theu, themeluesi i menduar i shkrimit, ia kishte paraqitur apo shfaqur krijimtarinë e tij Paroh Thamusi, Parohu e kishte çmuar dhe lavdëruar një teknikë të panjohur deri atëherë e cila supozohej se do t’ua mundësonte qenieve



njerëzore të mbajnë mend atë që në të kundërtën do ta harronin. Por, Thamusi nuk ishte plotësisht i kënaqur. “Theu im i ditur”, - kishte thënë ai, “kujtesa është një dhuratë e madhe që është mësuar të mbahet gjallë me anë të ushtrimit të vazhdueshëm të saj. Me zbulimin tuaj njerëzit më nuk do të jenë të detyruar ta ushtrojnë kujtesën e tyre. Ata do t’i kujtojnë gjërat jo të shtytur nga përpjekja e brendshme, por nga virtytet e një mjeti të jashtëm”.

Ne mund ta kuptojmë preokupimin e Thamusi. Shkrimi, si çdo zbulim tjetër teknologjik, do ta ketë topitur fuqinë humane, të cilën pretendon ta substituojë apo rforcojë. Shkrimi shihej si i rrezikshëm sepse ulte fuqinë e mendjes duke u ofruar qenieve njerëzore një shpirt të ngurtë, një karikaturë të mendjes, pra një kujtesë minerale.

Natyrisht, teksti i Platonit është ironik. Platoni kishte shkruar pa marrë parasysh argumentin e tij kundër shkrimit. Por, ai gjithashtu kishte pretenduar se diskursi i tij është rrëfyer nga Sokrati, i cili nuk ka shkruar (pasi që nuk ka botuar, ai përjashtohet apo vdes në kursin e luftës akademike). Mirëpo sot, askush nuk merret apo nuk i problematizon preokupimet e Thamusi dhe këtë për dy arsye të thjeshta: Së pari, ne e dimë se librat nuk janë mënyra që arrijnë ta bëjnë dikë tjetër të mendojë në vendin tonë; në të kundërtën, ato mund të konsiderohen makina që provokojnë mendime të tjera. Vetëm pas zbulimit të shkrimit është bërë e mundur që të shkruhet një krijim i llojit të kujtesës spontane siç mund të jetë ai si *A la Recherche du Temps Perdu* i Prustit. Së dyti, nëse dikur moti njerëzit kanë pasur nevojë që të ushtrojnë kujtesën e tyre me qëllim që t’i mbajnë mend gjërat, pas zbulimit të shkrimit atyre u është dashur që t’i ushtrojnë memoriet e tyre me qëllim që t’i mbajnë mend librat. Librat e

sfidojnë dhe e përmirësojnë kujtesën; ato nuk e mbushin atë me narkozë. Megjithatë, Parohu e ka vënë në pah një frikë që do ta quaja eternale: frikën se arritja e re teknologjike do të vrasë diçka që ne e cilësojmë të çmueshme dhe të frytshme.

E përdora fjalën vrasje me qëllim, sepse pak a shumë 14 shekuj më vonë, Viktor Hygo, në librin e tij *Notre Dame de Paris*, rrëfen për një prift, Klaud Frollon, i cili rri i mërzhitur në pjesën e lartë të katedrales së tij. Tregimi në *Notre Dame de Paris* zhvillohet në shekullin e XV-të pas zbulimit të shtypit. Para kësaj kohe, dorëshkrimet ishin pjesë e rezervuar për një numër të caktuar të elitës së përzgjedhur literare, dhe e vetmja hapësirë nga ku mësohej masa për tregimet e Biblës, për jetën e Krishtit dhe të Shenjtëve, për parimet morale, por edhe për të parët e historive nacionale ose edhe nocionet më elementare të gjeografisë dhe shkencave të natyrës (natyrat e njerëzve të panjohur dhe të mirat e barërave dhe gurëve), është siguruar me anë të imazheve të katedrales. Pra, katedralja mesjetare ka qenë një lloj TV-programi permanent dhe që nuk ndërrohej, i cili në njëfarë forme u tregonte njerëzve për gjithçka nga jeta e përditshmërisë, por edhe për përkushtimin apo besimin e tyre eternal. Por, tashmë, Frollo në tavolinën e tij e ka librin e shtypur dhe ofshan “ceci tuera cela”: kjo do ta vrasë këtë, ose, thënë me fjalë të tjera, libri do ta vrasë katedralen, ndërsa alfabeti do t’i vrasë imazhet. Libri do t’i shmangë njerëzit nga vlerat e tyre më të rëndësishme, duke inkurajuar informacionin e panevojshëm, interpretimin e lirë të skripturave, kuriozitetin e çmendur.

Gjatë të gjashtëdhjetave,

Mareshali Mekluan kishte shkruar librin e tij *Galaksia e Gytenbergut*, ku kishte bërë të ditur se rruga apo mënyra lineare e të menduarit e mbështetur nga zbulimi i shtypit tashmë është në teh të substituimit me një mënyrë tjetër që është edhe më globale, pra nëpërmjet mësimin dhe kuptimit nga imazhet televizive apo edhe mjetet e tjera të ngjashme elektronike. Nëse jo Mekluani, mund të thuhet se, shumë nga lexuesit e tij së pari do ta kenë drejtuar gishtin e tyre tregues në drejtim të ekranit televiziv e pastaj te libri duke thënë: “ky do ta vrasë këtë”. Nëse Mekluani do të ishte sot në mesin tonë me siguri do të ishte ndër të parët që do të shkruante



“Gytenbergu po hakmerret”. Sigurisht se kompjuteri është një instrument me anë të së cilit dikush mund të prodhojë dhe editojë imazhe, ndërsa instruksionet për ta bërë këtë dalin me anë të ikonave; por, njëkohësisht, është shumë e vërtetë se kompjuteri gjithashtu është bërë para së gjithash një instrument alfabetik. Në ekranin e tij gjenden tashmë fjalë dhe rreshta, dhe nëse doni ta përdorni kompjuterin ju duhet të dini të shkruani dhe të lexoni.

A ka dallime ndërmjet *Galaksisë së Gytenbergut* dhe kësaj të dytës për të cilën po flasim? Shumë. Së pari, vetëm procesorët e fjalës arkeologjike të viteve të tetëdhjeta

kanë prodhuar një lloj të komunikimit të shkruar linear. Por sot, kompjuterët nuk janë më linearë përderisa ata shpërfaqin strukturën hipertekstuale. Është shumë kurioze të përmendet fakti se kompjuteri ka lindur si makinë gjeneruese, e aftë për ta bërë hapin e vetëm në kohë, dhe në fakt, në thellësinë e kësaj makine, gjuha ende vepron sipas logjikës binare, të zero-njëshit, zero-njëshit. Megjithatë, ajo që del nga makina nuk mund të shihet më si lineare: është eksplozimi i fishekzjarrëve semiotike. Modeli i tij nuk është i linjës së drejtë sikur i galaksisë reale ku çdokush mund të përvijojë ndërlidhje të papitura ndërmjet yjeve të ndryshëm për të formuar imazhe të reja qiellore në ndonjërin nga pikat e lundrimit.

MIRËPO, ENDE ËSHTË EKZAKT KJO PIKË ku duhet të fillojë aktiviteti ynë i hetimit, sepse me anë të strukturës hipertekstuale ne zakonisht nënkuptojmë dy fenomene krejtësisht të ndryshme. Së pari, ekziston hiperteksti tekstual. Në librin tradicional leximi duhet të bëhet nga e majta në të djathtë (ose nga e djathta në të majtë, ose nga lartë poshtë,

sipas kulturave të ndryshme) në rrugë apo mënyrë lineare. Gjithashtu, mund të kalohet edhe nëpër faqe, kur arrihet shembull në faqen 300 mund kthehet prapa dhe të kontrollojë ose rilexojë në faqen 10 - por, nënkuptohet se kjo e do një punë fizike. Në kontrast të kësaj, teksti hipertekstual është një rrjet multidimensional apo një labirinth në të cilin çdo pikë apo një potencialisht mund të mbahet në lidhje me një tjetër. Së dyti, ekziston edhe hiperteksti sistemik. WWW është Nëna e Madhe e të Gjitha Hiperteksteve, një bibliotekë botërore ku ju mund të merrni, për një kohë të shkurtër, të gjitha librat që i dëshironi. Web-i

është sistemi gjeneral i të gjitha hiperteksteve ekzistuese.

Dallimi i tillë ndërmjet tekstit dhe sistemit është tepër i rëndësishëm dhe ne do të kthehemi tek ai. Por, në këtë moment, më lejoni ta likuidojmë njërën nga pyetjet më naive, që ndërlidhet me këtë dallueshmëri, e cila nuk po hetohet ende pastër. Por, që në pyetjen e parë do të na mundësohet që të qartësojmë pikën tjetër. Pyetja naive është: “A do ta bëjnë të papërdorshëm librin interneti, disketat hipertekstuale apo sistemet multimediale?”. Me këtë pyetje ne kemi ardhur në kapitullin përfundimtar të asaj që gjithmonë themi se kjo do ta mbysë këtë. Por, edhe kjo pyetje është konfuze, që kur dihet se ajo mund të formulohet në dy mënyra të ndryshme: (a) a do të zhduken librat si objekte fizike, dhe (b) a do të zhduken librat si objekte virtuale?

Më lejoni që së pari t’i përgjigjem pyetjes së parë. Edhe pas zbulimit të shtypit, librat nuk kanë qenë i vetmi instrument për përvetësimin e informacionit. Kanë qenë gjithashtu edhe vizatimet, imazhet e shtypura popullore, mësimet orale e kështu me radhë. Thjesht, librat kanë dëshmuar se janë instrumenti më i përshtatshëm për dhënien apo transmetimin e informacionit. Ekzistojnë dy lloje të librit: ato që janë për t’u lexuar dhe ato që janë për t’u konsultuar. Sa u përket librave që janë për t’u lexuar, rruga normale për leximin e tyre është ajo që unë do ta quaj “rruga e tregimit detektiv”. Ju filloni nga faqja e parë, ku autori u tregon juve se krimi është kryer, pastaj përcillni çdo hap të hetimit të procesit deri në fund, dhe përfundimisht e zbuloni se fajtori ka qenë shërbëtori. Fundi i librit është edhe fundi i përvojës suaj të leximit. Të vërejmë me këtë rast sepse e njëjta ndodh edhe kur ju lexoni, të themi, një traktat filozofik. Autori dëshiron nga ju që ta

hapni librin që nga faqja e parë, ta përcillni serinë e çështjeve që propozohen dhe pastaj të hulumtohet e të shihet se si arrihet deri të konkluzionet finale. Sigurisht, studiuesit mund ta ri-lexojnë një libër të tillë duke kërcyer nga një faqe në tjetrën, duke u përpjekur që ta izolojnë lidhjen e mundshme ndërmjet një mendimi të dhënë në kapitullin e parë me atë në fund. Ata gjithashtu mund të vendosin të izolojnë, të themi, çdo gjendje të fjalës “ide” në një libër të caktuar, duke tejkaluar kështu qindra faqe me qëllim që ta fokusojnë kujdesin e tyre në pasazhet që kanë të bëjnë me këtë nocion. Megjithatë, këto janë mënyra leximi, të cilat laiku do t’i konsideronte jo të natyrshme.

Pastaj janë librat që janë për t’i konsultuar, siç janë doracakët dhe enciklopeditë. Enciklopeditë janë hartuar për t’u konsultuar e jo kurrë për t’u lexuar nga faqja e parë deri tek ajo e fundit. Një person që do ta lexonte *Encyclopaedia Britannica-n* çdo natë para se të flinte, duke filluar nga faqja e parë e duke e synuar të fundit, do të konsiderohej si një karakter komik. Zakonisht merret një volum i caktuar i enciklopedisë me qëllim që të mësohet apo kujtohet për shembull se kur ka vdekur Napoleoni, ose cila është formula kimike e acidit sulfurik. Studiuesit i përdorin enciklopeditë në mënyrë më të sofistikuar. Për shembull, nëse unë dëshiroj të di se a ka qenë e mundur apo jo që Napoleoni ta takojë Kantin, unë duhet të zgjedh volumin K dhe volumin N të enciklopedisë sime: E zbuloj se Napoleoni ka lindur në vitin 1769 dhe ka vdekur në vitin 1821, Kanti ka lindur në vitin 1724 dhe ka vdekur në vitin 1804, kur Napoleoni ishte perandor. Prandaj, duke u bazuar në këto të dhëna, nuk ka qenë i pamundur takimi ndërmjet tyre. Me qëllim që ta konfirmoj këtë ndoshta do të më duhet ta

konsultoj biografinë e Kantit, apo edhe të Napoleonit, por në një biografi të shkurtër të Napoleonit, i cili ka takuar shumë persona të tjerë në jetën e tij, takimi i mundshëm i tij me Kantin mund të jetë nënvlerësuar, ndërsa në biografinë e Kantit mund të shënohet takimi i tij i mundshëm me Napoleonin. Thënë shkurt, unë duhet të shfletoj nëpër shumë libra dhe nëpër shumë dollapë të bibliotekës sime; mua më duhet pastaj të marrë shënime dhe në fund t’i krahasoj të gjitha të dhënat që i kam mbledhur. E gjithë kjo do të më kushtojë shumë punë fizike.

Kurse me hipertekstin unë mund të lundroj nëpër tërë rrjet-enciklope-



dinë. Unë mund të ndërlidhem me një ngjarje që është regjistruar në fillim me anë të serive të ngjarjeve të ngjashme të shpërndara nëpër tekst; unë mund ta krahasoj fillimin me fundin; unë mund të kërkoj listën e fjalëve që fillojnë me A; mund të kërkoj për rastet kur emri Napoleon ndërlidhet me emrin Kant; mund t’i krahasoj gjithashtu edhe datat e lindjes dhe vdekjes së tyre - thënë shkurt, mund ta kryejë punën time për disa sekonda apo për disa minuta.

Nga anglishtja N. K.

(vijon në numrin e ardhshëm)

U MBAJT MANIFESTIMI NDËRKOMBËTAR *JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË*

(Prishtinë, 3-8 prill 2006)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Zyra e ShBA-ve në Prishtinë, organizuan për të katërtën herë më radhë, më 3-8 prill 2006, manifestimin tradicional ndërkombëtar *Java e Bibliotekës në Kosovë*.

Gjatë ditëve të këtij manifestimi pati ligjërata, seminare, trajnime në fusha të ndryshme të bibliotekarisë, si dhe aktivitete të rëndësishme kulturore. Ligjëratat nga ekspertë të bibliotekarisë nga vende të ndryshme të botës, sidomos ata nga ShBA, por edhe Gjermania e Franca, u përcollën me interesim të veçantë, si nga ekspertë amerikanë - Barbara J. Ford: "*Informacionet Qeveritare dhe Biblioteka*"; "Roli i Bibliotekës Universitare", Rebeka Lubas: "*Katalogimi i videove dhe incizimeve zanore*"; "*Katalogimi i hartave dhe filmave*", "*Materialet audio- vizuale dhe rëndësia e tyre në Biblioteka*; pastaj, tema nga eksperti gjerman - Adrian Williams: "*Artistët bashkëkohorë dhe librat*, nga Franca - Alain Mussuart, përgjegjës në Bibliotekën e Institutit Francez në Pragë: "*Bibliotekat Digjitale*", etj.

Gjatë *Javës*, informacione dhe përvoja të rëndësishme paraqitën Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës. Punëtorët BKUK-së, të cilët u trajnuan në Kolegjin Simmons në SHBA, prezantuan përvojat e tyre në bibliotekat e



Amerikës. Udhëheqësit profesional të BKUK-së, të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me përpunimin e të dhënave dhe menaxhimin e Programit të automatizuar bibliotekar Aleph 500, patën një prezantim të rezultateve të arritura në BKUK nëpërmjet këtij programi.

Në *Javën e Bibliotekës në Kosovë* pati edhe aktivitete nga Zyra dhe Misionet e jashtme diplomatike në Kosovë, veçjme, në këtë kontekst, ekspozitën etnografike: "*Veshje tradicionale rumune*", organizuar nga Zyra Rumune në

Prishtinë. Pastaj - ekspozita personale e piktorit akademik Rexhep Ferrit; ekspozitë e librit me tituj të veçantë në gjuhën angleze; ekspozitë e titujve më të ri që kanë hyrë në BKUK; mbrëmje letrare; koncerte të muzikës klasike.

Gjithashtu, në *Javën e Bibliotekës në Kosovë*, aktivitete u zhvilluan edhe në Bibliotekën ndërkomunale të Mitrovicës të Gjilanit dhe të Gjakovës, si dhe në Bibliotekën "Përralla" në Prishtinë. Gjatë *Javës së Bibliotekës në Kosovë*, u mbajt edhe *Dita e Donatorëve* të BKUK-së

ZYRA E SHBA-ve DHE BKUK NDIHMOJNË BIBLIOTEKËN E SKENDERAJT

(Skenderaj, 5 maj 2006)

Në Skenderaj, më 5 maj 2006, u hap biblioteka e tipit amerikan, në kuadër të projektit "Zhvillimi i bibliotekave të Kosovës". Pra, BKUK, në kuadër të iniciativës për pavarësimin dhe zhvillimin e bibliotekave dhe të veprimtarisë bibliotekare, bashkë me Zyrën e SHBA-ve në Prishtinë,

janë iniciuesit dhe donatorët kryesorë për modernizimin e bibliotekës së Skenderajt. Zyra e SHBA-ve në Prishtinë ka ndarë një donacion me vlerë 20.000 dollarë amerikan për pajisje teknike, kryesisht kompjuterë dhe pajisje të tjera ndihmëse, si dhe për pasurim të fondeve edhe me libra botimesh të reja.



KRYEPARLAMENTARI KOLË BERISHA PRITI DREJTORIN E BKUK-së

(Prishtinë, 8 maj 2006)

Kryetari i Kuvendit të Kosovës - z. Kolë Berisha, priti drejtorin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - dr. Sali Bashota, i cili e njoftoi kryeparlamentarin për punët dhe projektet që është duke realizuar BKUK-ja. Njëri nga projektet më të rëndësishme që tashmë pritet ta realizojë biblioteka "Kujtesa e Kosovës", ishte temë e bisedës së kryeparlamentarit me drejtorin e kësaj biblioteke, për të gjetur mundësitë e bashkëpunimit dhe të ndihmës nga Parlamenti i Kosovës dhe nga institucionet e tjera qeveritare. Përveç projekti, pritet që BKUK të japë ndihën e vet profesionale edhe për Bibliotekën e Kuvendit të Kosovës, si dhe për themelimin e Bibliotekës Presidenciale.

KARA J. BREISSINGER VIZITOI BKUK-në

(Prishtinë, 20 korrik 2006)

Kara J. Breissinger, zyrtare e Programeve për Çështje Globale dhe Komunikim të Zyrës për Informacione Ndërkombëtare të Departamentit Amerikan të Shtetit, e shoqëruar nga zyrtarë të Zyrës Amerikane në Prishtinë, vizitoi BKUK-në.

Qëllimi i vizitës së saj në Kosovë ishte njoftimi për së afërmi me investimet që Departamenti i Shtetit Amerikan po i jep BKUK-së në zhvillimin e saj. Ajo u njoftua me të gjitha investimet e Zyrës Amerikane në Prishtinë për BKUK-në, e veçanërisht me zhvil-



limet e *Javës së Bibliotekës në Kosovë*. Zonja Breissinger shprehu gatishmëri për të mbështetur edhe më tutje aktivitetin e *Javës së Bibliotekës*. Zonja Breissinger pati takim edhe me Shoqatën e Bibliotekarëve të Kosovës.

VIZITË E DREJTORIT TË BKUK-së NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE TË FRANCËS

(Paris, 28-29 korrik 2006)

Drejtori i BKUK-së, Dr. Sali Bashota, qëndroi, për vizitë zyrtare, në Francë, më 28-29 korrik 2006, ku ishte takuar me përfaqësues të lartë të bibliotekave franceze. Gjatë këtyre takimeve është shprehur gatishmëri për fillimin e bashkëpunimit mes Bibliotekës Kombëtare të Francës dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës në fushën e shkëmbimit, si dhe për mundësinë e shkollimit në Francë të stafit të BKUK-së në fushën e konservimit dhe të restaurimit të materialeve

bibliotekare. Drejtori i BKUK-së ka vizituar edhe bibliotekën e qytetit të Dizhonit dhe është takuar me drejtorin e kësaj biblioteke - Andrea Pierre Syren. Me rëndësi të veçantë ishte edhe takimi me Agnes Saal, drejtoreshë e përgjithshme e Bibliotekës Nacionale "François Mitterand" në Paris, si dhe takimi me Frederique Duversin, drejtoreshë e Qendrës Kulturore të Kosovës në Paris. Kjo qendër është themeluar në Paris në vitin 2006 dhe pritet të ketë një rol të rëndësishëm për promovimin dhe prezantimin e kulturës shqiptare.

EKSPERTË AMERIKANË TË BIBLIOTEKARISË NDIHMOJNË PROJEKTIN PËR ZHVILLIMIN E QENDRËS SË BIBLIOTEKËS UNIVERSITARE

(Prishtinë, 1 - 8 gusht 2006)

Më 1 deri më 8 gusht 2006, me ndihmën e Zyrës Amerikane në Prishtinë, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ka qëndruar një grup ekspertësh - bibliotekarë amerikanë, për të ndihmuar projektin për zhvillimin e Bibliotekës Universitare, në kuadër të ndihmës së mëhershme që është dhënë për shkollimin e bibliotekarëve kosovarë në Amerikë. Ekspertët nga Shtetet e Bashkuara të

Amerikës, Terry Plum, Rebecca Henning, Pamela Skinner, Brian Kysela, kanë punuar së bashku me personelin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare që Biblioteka Universitare, në fillim të vitit të ri akademik 2006 - 2007, të jetë e gatshme t'u shërbejë studentëve të Universitetit të Prishtinës.


Ekspertët nga Amerika kanë sjellë edhe një fond të librave profesionale në fushën e bibliotekarisë dhe të teknologjisë, që do të shërbejnë si



pika referimi për ndryshimet dhe konceptet më të reja në bibliotekë.

RUAJTJA DHE KONSERVIMI I LIBRIT / PËRGATITUR NGA: SHQIPE DRESHAJ - ASLLANI, BLERTA SLISHANI - KRASNIQI, BKUK, PRISHTINË 2006, 146 F.

Një libër paksa i veçantë nga botimet e zakonshme bibliotekare është libri "Ruajtja dhe konservimi i librit". Ky libër, i cili njëkohësisht është edhe një udhëzues për punën praktike, shqyrton probleme që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe konservimin e librit dhe materialeve të tjera bibliotekare. Libri është ndarë në VI kapituj, ku trajtohen probleme të përgjithshme kryesore që janë të lidhura, njëkohësisht, drejtpërdrejt, me punët e përditshme dhe me standardet në të cilat kryhet, kryesisht, sot, te ne, restaurimi dhe konservimi i materialeve bibliotekare. Kapitulli i parë fillon me një përshkrim historik të letrës dhe përmbajtjes së saj; i dyti me ruajtjen e librit (vendosjen e librave në raftet, ndriçimin dhe pastërtinë e depove, etj.); i treti me konservimin (me mënyrat e konservimit, dezinfektimin, dezinfektimin, përgatitjen e materialeve kimike, me mënyrat e restaurimit); i katërti me ruajtjen e materialeve të tjera (fotografitë dhe mikrofilmat); i pesti me materialet e dëmtuara rënd; i gjashti, ndërsa, me funksionimin e Qendrës së Restaurimit dhe Konservimit, si dhe me Libërlidhjen.



Libri, që të jetë sa më praktik, është pajisur edhe me fotografi dhe ilustrime të ndryshme, të cilat janë marrë gjatë procese të punës së autoreve në Qendrën e Restaurimit dhe Konservimit, që funksionon në kuadër të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Dhe, gjithashtu, libri është pajisur edhe me një fjalorth të termave që kanë të bëjnë me fushën e restaurimit dhe të konservimit.

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË, 3 (11-16 PRILL 2005), BKUK, PRISHTINË 2006, 151 F.

Botimi tashmë tradicional, Java e Bibliotekës në Kosovë 3, Prishtinë 2006, është një përmbledhje e ligjëratave që janë mbajtur gjatë këtij manifestimi kulturor bibliotekarë, që organizohet nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës. Ky numër prezantohet me shkrime të pasura, kryesisht nga fusha e bibliotekarisë, të autorëve vendës dhe të huaj, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre profesional gjatë kësaj Jave. Libri është ndarë në kapituj tematikë si: Ligjëratat dhe Kumtesat; 600-Vjetori i lindjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut; Koleksioni fonografik me fjalimet e Nolit; Ekspozitat e Javës; Gjendja e bibliotekave publike 1990 - 2005.



Edhe në këtë numër shtellohen tema dhe probleme me interes për kulturën dhe bibliotekarinë në përgjithësi, si: ide dhe koncepte të reja për bibliotekat, koleksionet, standardet bibliotekare, për trashëgiminë e shkruar etj. Në këtë botim, vend të veçantë zënë punimet edhe nga fusha e historisë nacionale - kushtuar 600-Vjetorit të Skënderbeut, për të cilin dhe për të cilën periudhë japin opinionet dhe burimet e tyre studiuesit: Dr. Jahja Drançolli, Dr. Ymer Jaka, Dr. Rexhep Munishi dhe Shyqri Nimani. Ky botim përmban edhe shkrime komplekse, në fushë të teknologjisë informative – përpunimit dhe menaxhimit të informacioneve bibliotekare dhe zhvillimeve intelektuale nëpër të cilat po kalon bibliotekaria sot, nga emra të njohur të bibliotekarisë botërore dhe rajonale, si: Dr. Irene Owens, Stephen Short, Jean Arthur Creff, Taher Khalifa, Etleva Domi. Ky numër përmban edhe shkrime nga fusha e publicistikës, kritikës së artit etj.